

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

UDHËTIMI

Imam Gazali

Prishtinë, 2017

Ihjau Ulumid-din
Ringjallja e diturive fetare
Imam Gazali

Titulli i originalit:
Kitâbu Adabi's-Sefer
Libri 17

Përgatiti dhe përktheu
Is'hak Shaladhe Abdullah B. Ferizi

Lektor:
Shenaj Zeneli

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

PARATHËNIE

Hamd (falënderimi) i takon vetëm Allahut, që robëve të Tij të devotshëm ua hapi largpamësinë (basiret) dhe ua fuqizoi atë me dituri dhe ibadete. Salat dhe selam zotërisë së njerëzimit, Muhammedit s.a.v.s., ehli bejtit, as'habëve të tij dhe atyre që pasojnë ahlakun dhe sunnetin e tij.

Tani dije se: udhëtimi është sebeb, ose për të shpëtuar me largim nga diçka ose për të arritur atë që dëshirohet, e ky udhëtim është dy llojesh:

a) udhëtimi me trup, nëpër qytete, male e vende tjera, e që është udhëtim *zahir*; dhe

b) udhëtimi me zemër, nga shkalla më e ultë (*esfeli safilin*) për në botën e *melekutit*, e që është udhëtim *batin*.

E udhëtimi i dytë është më i vlefshëm.

Ai që mjaftohet me gjendjen nga fëmijëria dhe me adetet që i ka mësuar nga prindërit, ai llogaritet se ka ngecë në shkallëtë ultë, ka pranuar mangësitë dhe e ka shkëmbyer xhenetin e gjerë sa qiejtë e toka bashkë, me një burg të errët e të ngushtë.

Sa bukur ka thënë poeti:

*Turpin më të madh te njerëzit që e pashë:
mund t'ishin t'përkryer, por të mangët i lashë.*

Por le të dihet se për shkak të rreziqeve të shumta, në këtë rrugë nuk mund të udhëtohet pa një udhërrëfyes dhe mbrojtës. Në mungesë të udhërrëfyesit, udhëtarët e kësaj rruge kënaqen me pak dhe heqin dorë nga dobi më të mëdha, e me këtë edhe e braktisin udhëtimin, qoftë ai udhëtim në hapësirat tokësore, në botën e melekutit, apo edhe në vetvete.

E Allahu Teala na fton në këtë udhëtim:

“Ne do t'ua bëjmë atyre të mundshme që t'i shohin argumentet Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete.”⁴¹-Fusilet: 53

**“Në tokë ka argumente për të bindurit.
por edhe në veten tuaj. A nuk e shihni?”**

51-Dharijat: 20-21.

Kurse ata që e braktisin këtë udhëtim, Allahu Teala i qorton:

**“Ju që kaloni pranë rrënojave të tyre në mëngjes dhe natën,
A nuk po e mbliidhni mendjen?”**

37-Safat: 137,138

“Sa e sa argumente ka në qiej e në tokë, të cilët i shohin, por ata nuk mendojnë.” 12-Jusuf:105.

Atij që i bëhet kështu ky udhëtim, ai do të shëtisë bahçet e xhenetit, edhe kur me trup nuk lëvizë. Këtë udhëtim, kallaballëku nuk e ngushtone as nuk e vështirëson. Përkundrazi, me shtimin e udhëtarëve, dobitë shumëfishohen.

E përfitimet nga ky udhëtim nuk mbarojnë, ato janë të vazhdueshme. Frytet e tij vetëm shtohen, pa u pakësuar. Por, nëse udhëtari dembeloset dhe ndalet, edhe nimetet e udhëtimit ndërpriten.

Allahu Teala nuk i ndërpret nimetet që i ka dhuruar atyre deri sa ata nuk ndërrojnë gjendjen e vet. Kur ata largohen nga haku, Allahu Teala ua merr ato nimete. Përndryshe, Allahu Teala nuk i bën zullum askujt, pos që njerëzit i bëjnë zullum vetes.

Kush nuk është i denjë që të hyjë në këtë mejdhan dhe të shëtisë bahçet e xhenetit, ai me trup udhëton me kilometra, qoftë për tregti të kësaj bote, ose edhe pas fitimit për ahiret. Por, vetëm nëse për qëllim të udhëtimit ka diturinë ose është udhëtim për të ndihmuar fenë, atëherë ai është udhëtar në rrugë të ahiretit.

Në këtë udhëtim ka disa rregullatë sjelljes (*adab*) dhe kushte (*shart*). Kush nuk i respekton këto, bëhet ndjekësi dynjasë dhe shejtanit. E kush i respekton, mbërrinë dobitë e ahiretit.

Me lejen e Allahut Teala, ne do t'i shpjegojmë këto kushte dhe rregulla të sjelles, në dy kapituj:

Kapitulli i parë
RREGULLAT E SJELLES NË UDHËTIM

Pjesa e parë

DOBITË, VLERA E LARTË DHE NIJETII UDHËTIMIT

Dije se: udhëtimi është lëvizje në një vend tjetër dhe shoqërim. Kjo i ka edhe dobitë edhe dëmet e veta, e që ne i shpjeguem në librat *'Edukata në miqësi'*, dhe *'Uzlet'*.

Dobitë që inkurajojnë në udhëtim janë ose në largim prej diçkaje ose në kërkim të diçkaje. Udhëtari, ose ka diçka që e shqetëson atje ku është, e po të mos ishte ai shqetësim nuk do të udhëtonte, ose ka qëllim të qartë dhe e di se çfarë kërkon.

Diçka që e shqetëson e që mund të bëhet shkak për largim janë epidemitë, fitnet (ngatërresat) apo edhe çmimet e larta. E këto shkaqe, ose janë të përgjithshme, ose personale. Shkaku personal për largim është padrejtësia ndaj tij në vendin e vet, që e bën të dëshirojë të lagohet nga aty.

Pra, këto janë shkaqe të dynjallëkut për udhëtim. Ose, personit i duhet të largohet nga vendi i tij për shkak të telasheve në çështje të fesë.

Për shembull: personi që është i pasur dhe me pozitë, e kjo situatë e pengon në ibadetin e tij, prandaj ai braktisë pasurinë dhe pozitën e vet duke preferuar kurbetin për ta bërë ibadet me sinqeritet ndaj Allahut. Ose e detyrojnë me dhunë t'i përshtatet ndonjë bidati ose detyrohet të bëjë ndonjë veprim të ndaluar, e këto janë shkaqe nga të cilat ky dëshiron të shpëtojë me largim.

Edhe udhëtimi në kërkim të diçkaje është dy llojesh: ose është për dynjallëk, si kërkimi i parasë e pozitës, ose për fe, si udhëtimi në kërkim të diturisë dhe për veprim.

Edhe dituria mund të jetë për çështje të kësaj bote, ose dituri për ahlakun, që arrihet me përvojë, ose mund të jetë dituri për mrekullitë e botës, siç ishin udhëtimet e Dhul-Karnejnë pjesë të ndyshme të botës.

E veprimi mund të jetë *ibadet* ose *zijaret* (vizitë). Ibadet janë udhëtimet si haxhi, umre dhe xhjadi. Edhe vizita llogaritet një lloj ibadeti.

Nganjëherë qëllim është të vizitohen robët e mirë të Allahut dhe dijetarët; nëse kanë vdekur, ju vizitohen varret, e nëse janë gjallë, merret bereqet duke i shikuar ata. Shikimi i gjendjes (*hal*) së të tyre, lind dëshirën për të vepruar si ta.

Këto janë arsyet për udhëtim, e nga kjo ne mund të nxjerrim disa lloje të udhëtimit:

1. Udhëtimi në kërkim të diturisë

Kjo dituri mund të jetë *vaxhib* (obligative) ose *nafile* (vullnetare), varësisht çfarë diturie kërkohet. Nëse dituria është *vaxhib* edhe udhëtimi është *vaxhib*, e nëse dituria është *nafile*, edhe udhëtimi është *nafile*, pra sunnet. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush largohet nga shtëpia në kërkim të diturisë, ai është në rrugë të Allahut, deri sa të kthehet.”¹

e në një transmetim tjetër:

“Kush udhëton në kërkim të diturisë, Allahu ia lehtëson rrugën për në xhenet.”²

Seid ibn Musejeb udhëtonte disa ditë vetëm për të mësuar një hadith, e Sha’biu ka thënë:

“Po të udhëtojë njeriu nga Shami në Jemen vetëm për një fjalë që do ta udhëzonte në rrugë të drejtë ose do ta largonte nga të këqijat, udhëtimi nuk do t’i ishte i kotë.”

Xhabir ibn Abdullah u nis me dhjetë as’habë të tjerë prej Medines për në Egjipt dhe udhëtuan këmbë për një muaj, vetëm për të dëgjuar nga goja e Abdullah ibn Unejs Ensaritnjë hadith, pasi kishin marrë vesh se ai i

¹Tirmidhiu nga Enesi.

²Muslimi.

kishte dëgjuar ato fjalë vetë nga Pejgamberi a.s.. Që nga koha e as'habëve e deri më sot, shumë dituri janë perfituar në udhëtime të tilla.

Edhe dituria për nefsin (veten) dhe ahlakun është i rëndësishëm. Nisja në rrugë të ahiretit është e mundur vetëm me përmirësimin e ahlakut. Ai që nuk i njeh të fshehtat e brendësisë së tij dhe të këqijat e cilësive të veta, nuk do të jetë në gjendje ta pastrojë zemrën nga to. E për këtë del në udhëtim, me qëllim që të kuptojë dhe të përmirësojë ahlakun e vet. Udhëtimi shfaqë ahlakun e udhëtarit. Me udhëtim njeriut i shfaqen fshehtësitë në qiej e në Tokë. Është quajtur *sefer* (udhëtim) sepse përmes tij shfaq dhe ndriçon ahlakun e personit. Prandaj hazreti Omeri r.a., edhe ka pyetur njërin që duhej të ishte dëshmitar:

- *A ke udhëtuar me këtë person.* Ai tha:

- *Jo., e Hazreti Omeri r.a., i tha:*

- *Atëherë ti nuk e njeh ahlakun e tij.*

Bishri thoshte: *“O dijetarë, udhëtoni, do të jeni të mirë. Edhe uji është i mirë kur rrjedhë, e nëse qëndron në vend, prishet.”*

Shkurt, veset nuk i shfaqen askujt atje ku banon, sepse aty është i rrethuar me çka është mësuar. Por kur

shijon udhëtimin e hidhur, ndahet nga ajo me çka është mësuar dhe ballafaqohet me vështirësitë e udhëtimit, atëherë i shfaqen veset dhe i sheh dobësitë e veta. Pikërisht atëherë është e mundur t'i qaset shërimit të tyre. Në librin **'Uzlet'** tashmë i kemi përmendur dobitë e shoqërimit, e edhe udhëtimi është një lloj shoqërimi, me një angazhim shtesë dhe vështirësi që duhet duruar.

Sa për argumentete Allahut Teala në sipërfaqen e Tokës -në to ka dobi të madhe, për atë që i shikon me vëmendje. Gjatë udhëtimit në sipërfaqen e Tokës njeriu sheh lugina, male, shkretëtira e oqeanë, sheh kafshë dhe bimë të ndryshme, dhe të gjitha ato e dëshmojnë Allahun Teala dhe njëshmërinë e Tij, dhe e lavdërojnë Allahun me një gjuhë të mrekullueshme, gjuhë të cilën mund ta kuptojë vetëm ai që dëgjon, me vëmendje e me zemër.

Ndërsa mohuesit dhe ateistët (*qafir*) që janë mashtruar me shkëlqimin e stolisur të dynjasë, as nuk shohin e as nuk dëgjojnë, sepse atyre Allahu Teala ua ka mbuluar dëgjimin dhe shikimin nga shenjat e Tij. Prandaj në një ajet thuhet:

“Ata dinë vetëm anën e dukshme të kësaj jete, ndërsa për jetën tjetër janë të pakujdesshëm.”

30-Rum: 7

Nuk po mendoj në dëgjimin e jashtëm, me vesh; ata për të cilët po flasim nuk janë të privuar nga kjo. E kemi

fjalën për dëgjimin e brendshëm, me vëmendje e me zemër. Në dëgjimin me vesh njeriu është i barabartë me kafshën. Ndërsa dëgjimi me zemër e kupton të folurit e gjendjes (*hal*), e kjo e folur është krejt ndryshe nga të folurit me gjuhë. Është i ngjashëm me atë të folurën mes gozhdës e murit, kur muri e pyet gozhdën: “*pse më shpon?*”, e kjo ia kthen: “*pyet atë që më godet*”.

Secila grimcë, në qiej e në Tokë, e dëshmon Njëshmërinë e Allahut Teala. Ato kanë mënyra të ndryshme me të cilat dëshmojnë Krijuesin e tyre të përsosur, e që është tespihu (lavdërim Allahut) i tyre. Njerëzit nuk e kuptojnë këtë tespitë të tyre sepse nuk kanë udhëtuar përtej kufizimeve të dëgjimit të jashtëm drejt hapësirave të dëgjimit të brendshëm; nga thatësia e gjuhës së dynjallëkut, kah pasuria e gjuhës së gjendjes (*hal*).

Po të ishte secili i aftë për këtë, atëherë kuptimi i gjuhës së zogjëve nuk do të ishte veçori e Sylejmanit a.s., e veçori e Musasë a.s. nuk do të ishte dëgjimi të folurit të Allahut Teala, që gjithsesi nuk bëhet me germa e zëra.

Kush merr rrugë për t’i gjetur këto dëshmi të shkruara mahnitshëm nga Allahu Teala në faqet e natyrës nuk ka nevojë të ndahet nga vendbanimi i tij;

aty ku është, ai dëgjon me zemër të qetë secilin trespih të këndshëm të secilës grimcë. Ai nuk do të ketë nevojë të shpërngulet në shkretëtira, fusha e male, sepse do t'i mjaftojnë fshehtësitë dhe bota e melekutit. Dielli, Hëna dhe yjet i nënshtrohen atij.

Është e habitshme se si ai të cilit i është urdhëruar ta vizitojë Qaben, jepet pas vizitave të xhamiave tjera. E quditshme është edhe që, ai rreth të cilit qiejt bëjnë tavaf, shkon e i viziton pjesët e ndryshme të botës. E udhëtari ende mbetet i etur për të parë çkado qoftë nga kjo botë (*alemul-mulk ve shehade*) me syrin e tij fizik. I tilli bën pjesë në grupin e parë të njerëzve që udhëtojnë drejt Allahut. Ai pret në derën e shtëpisë dhe ende nuk ka kaluar në hapësirën kozmike. Nuk ka arsye për pritje më të gjatë në këtë gradë, pos frikës dhe mangësisë.

Një udhëtar shpirtëror pat thënë: *“Njerëzit thonë: ‘Hapi sytë e shih’, unë them: ‘Mbylli sytë e shih!’”*

Të dy shprehjet janë të sakta, thënia e parë i përshtatet gradës së parë, atij që pret në derën e shtëpisë, deri sa thënia e dytë është për gradat tjera, përtej derës së shtëpisë, e që i kalojnë vetëm ata që rrezikojnë.

Udhëtari në këtë rrugë mund të sorollatet me vite, por, me ndihmën e Allahut, mund edhe të drejtohet në rrugë të drejtë e të ketë sukses. Megjithatë, më shumë

ka të tillë që janë shkatërruar duke u humbur në këtë rrugë. Vetëm ata që udhëtojnë me nurin (dritën) e suksesit do të arrijnë në lumturi si edhe pasurinë e përjetshme. Këtyre qysh më herët u është shkruar sukcesi nga Allahu Teala. E ti krahaso këtë pasuri me pasurinë e kësaj bote! Sa shumë ka njerëz, e vetëm një numër i vogël prej tyre e kërkon atë pasuri. E sa më e madhe të jetë ajo çka kërkohet, aq më të vogla mundësitë për ta gjetur. Prandaj më shumë ka të tillë që shkatërrohen në këtë rrugë, se sa prej atyre që arrijnë suksesin. Për shkak të rreziqeve të mëdha dhe vuajtjeve të gjata në kërkim të kësaj pasurie të përjetshme, frikacakët nuk do të guxojnë ta marrin këtë rrugë. Një poet ka thënë:

*Sa më shumë dëshira shtohet,
aq më shumë trupi lodhet.*

Allahu i ka vendosur fenë, pasurinë në dynjallëk dhe madhështinë përtej rreziqeve. Për ta arritur atje duhet të llogaritet rreziku. Frikacaku pohon se frika vjen nga mendja e shëndoshë, por kjo nuk është drejtë. Siç ka thënë poeti:

*Frikacaku e sheh frikën zgjuarsi,
mashtrim i keq i tabiatit tëtij.*

Ky është shpjegimi i udhëtimit të jashtëm, kur me atë dëshirohet udhëtim i brendshëm për të shikuar

shenjat e Allahut Teala në Tokë. E tash t'i kthehemi qëllimit tonë e ta shpjegojmë atë!

2. Udhëtimi për ibadet

Ky mund të jetë udhëtimi për haxh, umre ose xhihad. Vlerën e lartë, rregullat e sjelljes dhe veprimet që lidhen me to, si të jashtme ashtu edhe të brendshme, tashmë i kemi shpjeguar në librin *'Fshehtësitë e haxhit.'*

Këtu hyjnë edhe vizitat në varret e Pejgamberëve a.s., as'habëve, taibinëve, si edhe të dijetarëve tjerë dhe robëve të mirë e të devotshëm. Ata prej të cilëve arrihet përfitim shpirtëror sa janë gjallë, vizitohen edhe pas vdekjes, te varri i tyre. Udhëtimi për këtë qëllim është i pranueshëm (*xhaiz*), ndërsa hadithi:

- **Udhëtimi bëhet vetëm për tri mesxhide: për mesxhidin tim** (në Medine), **për Mesxhidul-haram** (në Mekë) **dhe për Mesxhid-i Aksa** (në Jerusalem), nuk ndalohen këto vizita, sepse në hadith përmenden vetëm tri mesxhide. Pas tyre, mesxhidet tjera janë në vlerë të njëjtë mes vete. E në esencë, nuk ka dallim në vlerë të vizitës varreve të devotshmëve, evliave dhe dijetarëve, ani pse ka dallim shumë të madh në gradat e tyre.

Shkurtimisht, vizita të gjallëve është më e mirë se të vdekurve. Qëllim nga vizita të gjallëve është përfitimi

nga lutjet dhe nga shikimi i fytyrave të tyre. Shikimi i fytyrës së dijetarëve është ibadet. Kjo përmban nxitje për të përvetësuar cilësitë e tyre morale. Pos kësaj, aty është edhe dobia që përfitohet nga dituritë e tyre përmes asaj që flasin e bëjnë. E si të mos jetë kështu, kur në vizita vëllait mysliman për rizanë e Allahut ka vlerë aq të lartë, siç edhe e kemi shpjeguar në librin *'Edukata në miqësi'*.

E në Teurat, thuhet: *"Udhëto edhe katër milje, për të vizituar vëllanë tënd për rizanë e Allahut."*

Sa për vendet ku duhet të udhëtohet, janë tri mesxhidete përmendura në hadith, si edhe dalja karshi armikut.

Për vlerën e Mekes dhe Medines (dy Haremeve) tashmë kemi folur në *'Librin e Haxhit'*, e edhe Mesxhid-i Aksa ka vlerë të madhe. Ibn Omeri r.a., u nis një herë nga Medine për në Mesxhid-i Aksa. Kur arriti në qytet, i fali pesë namaze dhe menjëherë të nesërmen u nis për t'u kthyer në Medine. Sylejmani a.s. e luti Allahun Teala që të vështrojë me rahmetin e Tij personin që hyn në Mesxhid-i Aksa me qëllim që të falë namaz, dhe ta pastrojë atë nga gjynahet, sikur në ditën kur e ka lindur nëna. Allahu Teala ia pranoi këtë dua.

3. Largimi nga gjërat që e dëmtojnë fenë

Edhe kjo është e lavdëruar; largimi nga gjërat për të cilat nuk ka fuqi të mjaftueshme, është sunnet i Pejgamberëve. Gjërat prej të cilave duhet të largohet janë misioni qeveritar (në pushtetin e mizorit), pozita dhe sebetet që krijojnë kushte të ngatërresës në popull, apo edhe për shkak të pasurisë. Të gjitha këto e prishin qetësinë e zemrës, ndërsa urdhrat e fesë zbatohen plotësisht vetëm kur zemra preokupohet pos me Allahun.

Nëse qetësia e zemrës nuk është e plotë, as njeriu nuk mund t'i kushtohet plotësisht fesë. Megjithatë, nuk është e mundur të paramendohet qetësia e plotë e zemrës në dynja, nga obligimet e dynjallëkut dhe nga nevojat e përditshme.

Por, është e mundur të paramendohet se këto gjëra gjenden pjesërisht në zemër, ose e kanë mbuluar plotësisht atë. Ata që i kanë pak nga këto gjëra në zemër kanë shpëtuar, e ata që kanë shumë, janë shkatërruar. Hamd (falënderimi) Allahut që nuk e ka kushtëzuar që zemra duhet plotësisht të pastrohet nga të gjitha ngarkesat dhe barra e kësaj bote, por me rahmetin e Tij të pafund, i pranon edhe zemrat që në vete bartin diçka prej barrës së kësaj bote. Kjo është zemra për të cilën dynjallëku nuk është brenga më e madhe.

Por kjo nuk është e mundur për atë i cili ka post dhe pozitë të lartë e që interesohet për to. Për të shpëtuar i duhet të zgjedhë për një kohë kurbetin dhe të këputë lidhjet me çdo gjë. Vetëm në këtë mënyrë mund të kontrollojë veten dhe t'i nënshtrohet për një kohë ushtrimeve shpirtërore. Pas kësaj mund të ndodhë që me ndihmën e Allahut Teala arrin në bindje (jekîn) dhe zemra i qetësohet plotësisht. Atëherë, këtij i bëhet njëjtë se a rri në shtëpi apo udhëton, a ka ndonjë lidhje familjare e shoqërore, apo jo.

Asgjë nga këto nuk do ta pengojnë nga bërja dhikër Allahut. Por të tillë jashtëzakonisht rrallë gjinden. Në fakt, zemrat janë kryesisht të dobëta dhe të paafta që të pranojnë bashkë edhe krijesën edhe Krijuesin.

Në këtë gradë ngriten vetëm Pejgamberët dhe evliatë, dhe ajo gradë është shumë e vështirë të arrihet, sado që vepron e mundohet në këtë çeshtje.

Dallimi mes njerëzve në forcën e brendshme është dallimi mes tyre në forcën e gjymtyrëve të jashtme; sa e sa ka njerëz me muskuj dhe trup të fortë që me lehtësi ngritin pesha me qindra kilogramë.

Ndërsa personi me trup të dobët, sado që me stërvitje mësohet të ngritë peshë, ai nuk mund të arrijë në atë shkallë. Por, edhe nëse nuk mbërrinë të ngritë atë peshë, falë stërvitjes, fuqia i shtohet.

Prandaj nuk është e drejtë të humbet vullneti. Xhahilët e të devijuarit janë ata që i braktisin të gjitha duke thënë se nuk mundën të arrijnë grada më të larta.

Të parët e ndershëm, Allahu i mëshiroftë, e kishin zakon që të lëshojnë vendqëndrimet e tyre, nga frika e *fitnes* (ngatërresës).

Sufjan Sevri, ka thënë: *“Kjo është kohë e keqe. Në këtë kohë, nuk shpëton as i panjohuri, e lëre më ata që janë të njohur! Kjo është kohë kur njeriu duhet të lëvizë nga vendi në vend; sapo të bëhet i njohur diku, duhet të largohet.”*

Ndërsa Ebu Nuajm, ka treguar: *“E pashë Sufjan Sevrinë, në dorë mbante një shtambë, e në shpinë një çantë. E pyeta se kah është nisur, e më tha:*

- Kam dëgjuar për një vend ku çmimet janë të lira. Po shkoj atje të jetoj. E pyeta:

- Vërtetë do ta bësh këtë?!, e më tha:

- Po. Kur të dëgjosh për një vend ku është më lirë, atje shko e jeto, sepse kjo është më e sigurtë për besimin tënd, e edhe brenga është më e vogël.”

Ky është largim për shtrenjttimeve. E Serijj Sekati ju thoshte sufive: *“Sapo të kalojë dimiri e vjen pranvera, drunjtë mbushen me gjethe e fillon gjelbërimi, edhe ju shpërndahuni (udhëtoni) në sipërfaqen e tokës.”*

Ibrahim Havasi nuk qëndronte në një vend mbi katërdhjetë ditë, e ishte *mytevekkil* (i mbështetur plotësisht tek Allahu Teala). Qëndrimin në një vend më shumë se kaq duke besuar në sebepe, e konsideronte në kundërshtim me mbështjetjen tek Allahu. Inshallah në librin *'Tevekkul'*do të shpjegojmë të fshehtën e mbështetjes në sebepe.

4. Largimi nga rrezikimi i shëndetit

Nuk ka të keqe në largimin prej gjërave që e dëmtojnë shëndetin, siç është ndonjë sëmundje, por edhe largimi nga gjëra që e dëmtojnë pronën, nga shtrenjtimitet, e të ngjashme.

Lidhur me përfitimet, largimi nga disa vende mund të jetë detyrim (*vaxhib*)e nga vende tjera e lavdëruar (*mustehab*). Përrjashtim bën murtaja. Usame ibn Zejd transmeton se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Me këtë sëmundje janë dënuar disa popuj para jush. Ajo ka mbetur në Tokë; sa lajmërohet e sa zhduket. Kur dëgjoni se është paraqitur në një vend, mos shkoni atje! E nëse paraqitet aty ku gjendeni, atëherë mos dilni nga ai vend!”³

Sipas Ajshes r.anhum, Resulallahu s.a.v.s., tha:

- Shkatërrimi i ummetit tim është në luftë dhe murtajë.

- Këtë për luftën e dimë, po murtaja?

³Hadithi është muttefekun alejhi.

- Murtaja, si ajo e deves, ngjizet në stomak. Muslimani që vdes nga kjo, është shehid. Ai që qëndron (në vendin e murtajës) duke llogaritur në shpërblim prej Allahut, është sikur luftëtari në rrugë të Allahut, e ai që ik prej aty është si ai që ikë nga fushëbeteja.⁴

Mekhul transmeton se Ummu Ejmen ka thënë: “*Resulallahu s.a.v.s., e këshilloi një as’hab:*

- Mos i bëj Allahut shirk me asgjë, edhe nëse të mendojnë a të djegin. Nënshtrouju prindërve; edhe nëse të urdhërojnë të braktisësh të gjitha që i ke, ti braktisi. Namazin mos e lësho qëllimisht, sepse i tilli privohet nga mbrojtja e Allahut. Ruaju nga véna, sepse ajo është çelës i të gjitha të këqijave. Ruaju nga gjynahu, sepse shkakton urrejtjen e Allahut. Mos ik nga fushëbeteja. Nëse te njerëzit shpërndahet epidemi, e ti gjendesh mes tyre, qëndro me ta. Nga ajo që ke jep për familjen tënde dhe mos ua rëndo. Bëj që (vetëm) Allahut t’i frikësohen.⁵

Të gjitha këto hadithe tregojnë se ikja nga murtaja është e ndaluar, njëjtë si shkuarja atje ku murtaja është përhapur. Shpjegim më të hollësishëm për këtë do ta japim Inshallah në librin ‘*Tevekkul*’.

⁴ Ahmed ibn Hanbeliu dhe Ibn Abdalberr në ‘*Temhid*’, me zingjir të mirë të transmetuesve

⁵ Bejhekiu. Hadith mursel.

Pra, këto janë llojet e udhëtimit. Po del që udhëtimi mund të jetë i papëlqyer, i pëlqyer ose i lejuar (*mubah*).

Udhëtimi i papëlqyer ndahet në *haram*, siç është ikja e robit prej zotërisë, ose largimi duke kundërshtuar prindërit; ose *e papranuar*, siç është dalja nga vendi ku është përhapur murtaja.

Udhëtimi i lavdëruar ndahet në *obligativ*: siç është haxhi dhe kërkimi i diturisë së domosdoshme për secilin mysliman; dhe në të *preferuar*, siç janë vizitat dijetarëve ose varreve të tyre.

Nga të gjitha këto sebepe del edhe nijeti i udhëtimit. Ndërsa kuptimi i nijetit ka të bëjë pikërisht me sebepin që na motivon për udhëtim. Prandaj në secilin udhëtim nijeti duhet të jetë për rizanë e Allahut.

Nijet bëhet për udhëtimet e obliguara dhe të pëlqyeshme, ndërsa është absurde të bëhet nijet për udhëtimet e papranueshme. Nijet bëhet edhe për udhëtime të lejuara (*mubah*). Shembull:

Nëse qëllim e ka kërkimin e pasurisë në mënyrë që të shpëtojë nga lypësaria dhe të ruaj dinjitetin e familjes dhe fëmijëve të vet, ndërsa tepricën e jep sadaka, ky udhëtim është *mubah*, sepse edhe nijeti është vepër e ahiretit. E nëse niset për *haxh*, por motiv ka paraqitjen e famën, atëherë del nga korniza e veprimeve të ahiretit. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Veprat janë sipas nijetit.”⁶

⁶ Muttefekun alejhi

Kjo vlenë për veprimet farz (të obligueshme), ato mustehab (të preferuara) dhe *mubah* (të lejuara),e jo edhe për veprimet e ndaluara, sepse nijeti nuk i bën ato veprime të lejuara. Njëri nga të parët e ndershëm ka thënë:

“Allahu Teala udhëtarit i cakton melekë që kujdesen për nijetin e tij, dhe secilit i japin sipas nijetit. Kush ka nijet dynjallëkun, melekët edhe ia japin, por kjo i zvogëlohet shumëfish nga ahireti, telashet i shumohen e i shtohet pakujdesi. Nga ana tjetër, kush e ka nijet ahiretin, atij i dhuroheturtësiadhe mendjemprehtësia. Këtij, sipas nijetit, do t’i hapetsyri i zemrës e telashet i pakohen, ndërsa melekët bëjnë dua dhe istigfar për të.”

E sa për pyetjen se a është më i mirë udhëtimi apo vendqëndrimi, kjo është sikur të pyesësh sa është më e mirë vetmia (uzlet) apo shoqërimi me njerëz. Metodologjinë për t’ju qasur kësaj çështje e kemi përpunuar në *librin ‘Uzlet’*, sipas së cilës duhet kuptuar edhe udhëtimin.

Udhëtimi është një lloj kontakti me njerëz, ajo njeriut i sjell mund, lodhje e brenga. Më e mira është të zgjedhet ajo që më së shumti do të ndihmojë besimin, ndërsa kulmi i frytave të besimit në dynja është njohuria për Allahun dhe afërsiame Të përmes dhikrit.

Kjoafërsi arrihet me dhikër të pandërprerë, ndërsa njohuria (*marifat*) arrihet me mendim të vazhdueshëm. Ai që nuk i përmbahet rrugës së mendimit (*tefekkur*) dhe dhikrit, nuk do të ketë sukses.

Udhëtimi lehtëson përfitimin e diturisë, eshtëpia (vendqëndrimi) lehtëson veprimin. Udhëtimi i vazhdueshëm nëpër pjesë të ndryshme të rruzullit tokësor e shqetëson zemrën, përpos atyre që janë vërtetë të fortë, silbrahim b. Ed'hem. Udhëtari brengoset për vete dhe për pronën e tij, ani pse e di që Allahu e ruan. Prandaj zemra e udhëtarit është vazhdimisht e angazhuar. Nganjëherë frikësohet për vete e për pronën e vet, e nganjëherë për ndarjen prej asaj me çka është mësuar në shtëpi. E nëse nuk ka pronë për të cilën do të brengosej, atëherë do të ketë lakmi. Nganjëherë zemra i dobësohet për shkak të varfërisë, e nganjëherë, nga shpresa, zemra i forcohet. Sido që të jetë, largimi nga shtëpia është shqetësues. Prandaj muridi (nxënësi) nuk duhet të udhëtojë, pos me nijet të mësimit, ose për të kërkuar një shejh si udhërrëfyes e që do ta pasojë. Por nëse i kupton mangësitë veta dhe mundetvet t'i përmirësojë, e me këtë i hapet edhe rruga e mendimit dhe veprimit, atëherë më mirë të qëndrojë ku është.

Por, shumica e sufive të kohës së sotme, meqenëse të brendshmen e kanë të zbrazët për shkak të mendimeve të cekta dhe veprimeve të sofistikuara, dhe pasi që nuk kanë arritur afërsinë e Allahun Teala dhe dhikrin e Tij kur janë në vetmi -janë joproduktiv, jo të informuar, seriozisht joaktivë, dembelë dhe u vjen vështirë të punojnë çkado. Rruga e fitimit u duket tepër e vështirë ndërsa kërkesa dhe lypësaria të lehta. Ata kalojnë kohën në *ribatë*⁷, të ndërtuara për ta, e mysafirët dhe hizmetqarët atyia nënshtrojnë vetes. E shëmtojnë mendjen dhe besimin e vet, sepse mendja dhe puna e tyre është për dukje, dyfytirësi (rija), përfitim, famë, reputacion dhe pasuri. Ata nuk kanë asnjë ndikim në teqe. Ata nuk mund t'ju japin kurrëfarë edukimi të dobishëm muridëve, e as që mund të largojnë muridët nga të këqijat. Veshin rroba të leshta, eteqet ju duken argëtim. I kanë mësuar përmendësh disa fjalë të bukuraprej atyre që kanë folur në gjendje të dehur shpirtëroredhemundohen t'ju pergjajnë atyre në dukje fjalë, me veshje e në sjelljetë jashtme, dhe mendojnë se janë në rrugë të hajrit. Mendojnë që po veprojnë mirë. Kujtojnë se gjithçka e zezë është hurme. Besojnë se ngjashmëria nga jashtë lind ngjashmëri edhe përbrenda.

Ah, sa gabim janë! Sa budallaki e madhe është të mos dallohet yndyra nga kelbi! Të këtillët Allahu Teala nuk i do dhe i urren. Allahu Teala urren të riun që nuk e

⁷ Qendër e dërvishëve, ku mund edhe të flihet.

do punën, që sillet e vepron si rrugaç, të cilin në udhëtim nuk e nxit gjë tjetër pos rinia dhe mospuna. Të tjerë janë ataqë, për rizanë e Allahut udhëtojnë në haxh dhe umre (pa kërkuar famë), ose që udhëton të takohet me shejhun të cilin do ta pasojë në veprat e tij. Por, sot të tillë nuk ka. Në përgjithësi, besimi është dobësuar. Aq më shumë tasavvufi - plotësisht i shtrembëruar.

Por, dituritë nuk janë zhdukur. Nëse dijetari është i keq, e keqja nuk është në diturinë por në ahlakun e tij. Kështu, ai mbetet dijetar i cili nuk vepron me atë që di. Vepra është tjetër prej dijes.

E sa për *tasavvuf*, kjo është drejtimi izemrës së pastërdrejt Allahut dhe mosdhënia vlerë asgjëje tjetër. Thelb i tasavvufit janë veprimet me zemër e me gjymtyrë. Kur priset veprimi, humb edhe thelbi. Fakihët (juristët e shariatit) shprehinkujdes të theksuar për këso udhëtime, bile disa nga ata kanë thënë se këto udhëtime janë të ndaluara, sepse janë të panevojshme.

Por, mendimi i drejtë, sipas nesh, është që ky udhëtim të pranohet i lejuar, sepse të tillët, me vrojtimin e vendeve, njerëzve të ndryshëm dhe mënyrat e veprimit të tyre, ka mundësi të shpëtojnë nga dembelia. Nuk ka të keqe në lodhjen e kafshës së mjerë për një qëllim të mjerë. Fetvaja që jepet për këtë

çështje përfshinë edhe hutimin e njerëzve të rëndomtë për gjërat *mubah* në të cilat nuk ka as dobi as dëm. Ata që udhëtojnë vetëm për të shikuar, e që nuk është dobiprurëse as në fe e as në dynja, janë si bishat që enden andej-këndej në shkretëtirë. Udhëtimi i tyre nuk do të jetë i përbuzur, vetëm nëse me atë udhëtim nuk i bëjnë dëm tjetrit. Por, gjynahi i tyre do të jetë pikërisht në mashtrimin e tyre, në keqpërdorimin e termit *tasavvuf*, dhe në harxhimin e kotë të parave të vakëfit, të cilat janë dhënë për sufitëe vërtetë.

Sufi është term për një njeri të mirë e të drejtë në fenë e vet, e që pos mirësisë i ka edhe të gjitha cilësitë tjera fisnike. Sufiu i rremë ushqehet me atë që merr nga sundimtari, e të ushqyerit nga harami është gjynah i madh. Të tillët nuk kanë as drejtësi as mirësi. Nëse mund të paramendojmë që një sufi të jetë gjynahqar i madh, atëherë mund të paramendojmë edhe sufiun pabesimtar e fakihun çifut.

Siç është *fekih* shprehje për myslimanin me detyrë të caktuar, ashtu është *sufi* është shprehje për njeriun posaqërisht të drejtë. Në fenë e tij, ai nuk kufizohet vetëm me arritje të drejtësisë. E shumica prej jush, duke mos e njohur të brendshmen e sufive të vërtetë, mashtroheni me dukjen e jashtme të disave dhe u jepni për rizanë e Allahut Teala, e të merret kjo është haram,

dhe krejt çka konsumojnë nga kjo, nuk përputhet me shariat. Me këtë mendoj që, nëse dhënësi do ta njihte të brendshmen e gjendjeve të tyre, as nuk do t'ju dhuronte gjë. Kur një person merr para duke u deklaruar publikisht si *sufi*, ndërsa nuk e jeton tasavvufin në esencën e tij, atëherë ky është si ai që fiton para duke deklaruar se është sejid (nga soji i Resulallahut s.a.v.s.) Njerëzit i besojnë, ndërsa ky gënjen, e njerëzit i japin për shkak të dashurisë ndaj ehli-bejtit, e po ta dinin se po gënjen, nuk do t'i jepnin gjë.

Këto dhurata janë haram, siç është haram të merren para duke u deklaruar publikisht si *sufi*. Pikërisht për këtë, të kujdesshmit janë druajtur nga ngrënja dhe harxhimi si kundërpagesë për fenë. Edhe ai që është jashtëzakonisht i kujdesshëm për fenë e vet, prapë do të ketë disa fshehtësi, të cilat nëse i shfaqen atij që dëshiron t'i ndihmojë, dëshira e tij për ndihmesë do të venitet. Prandaj të këtillët nuk i blejnë vet gjërat që u duhen, duke u frikësuar se për shkak të devotshmërisë së tyre do të bëhen lehtësime për ta, e kështu të fillojnë të ushqehen si kundërpagesë për fenë, por e caktonin dikë tjetër që të blejë për ta, duke e kushtëzuar që të mos tregojë se për kë po blenë. Natyrisht, lejohet të merret çka jepet për qëllime të fesë, nëse dëshira e dhuruesit nuk do të venitej po të kuptonte të

brendshmen e pranuesit, ashtu siç e njeh Allahu. Njeriu i arsyeshëm dhe i ndershëm do ta dijë se kjo është e pamundur, ose tepër e vështirë, e i padijshmi do të mashtrohet edhe në çështje të fesë. Sepse më së afërti zemrës së personit, është vet zemra e tij, e nëse zemrën e vet nuk e kupton, si do ta kuptojë zemrën e tjetrit?! Kush e kupton hakikatin e kësaj, padyshim se i bëhet obligative të ushqehet vetëm me atë që vet e fiton, ose që ushqimin ta marrë vetëm nga dikush për të cilin me siguri të plotë e di se, edhe po t'i shfaqeshin këtij vetitë e fshehta, ai nuk do t'a përbuzte.

Nëse ai që kërkon hallallin dhe dëshiron të ndjekë rrugën e ahiretit do të detyrohej të marrë diçka nga tjetri, le t'i thotë haptazi: *“Nëse po më dhuron për shkak të mendimit tënd për mua, ta dish se nuk jam i denjë për këtë. Po të largonte Allahu Teala vellon që më mbulon, nuk do të më shihje më me nderim, veç do të mendoje se jam personi më i keq, ose njëri prej tyre.”*

Nëse edhe pas kësaj ky i dhuron, le të marrë. Ndoshta edhe do të jetë i kënaqur me atë cilësi të tij, sepse ky në fakt po e pranon si dobësi besimin e vet dhe që nuk meriton dhuratën. Por, këtu ka një hile të fshehtë të nefsit. Prandaj le të mendohet mirë.

Pra, ky mund të thotë ndonjëherë diçka vetëm sa të përngjajë me të mirët (*salihun*); fjala e tij në dukje është qortim, e në realitet, ai po e lavdëron veten. Sa ka prej të këtillëve! Qortimi i vërtetë i vetes (nepsit) është i pranueshëm vetëm në vetmi e para të tjerëve është rijallëk i pastër. Por kur me sinqeritet tregon të vërtetën për gabimet të veta, dhe kjo me të vërtetë ngjallë bindjen e dëgjuesit, atëherë nuk është *rija*. Siç është e mundur të tregohet ky kuptim simbolik, poashtu është e mundur që simbolet edhe të përzihen. Ai që është i sinqertë ndaj Allahut Teala është i vetëdijshëm që e ka të pamundur ta mashtrojë Allahun, njëjtë si edhe veten. I tilli nuk do ta ketë shumë të vështirë të ruhet nga gjëra të tilla.

Pra, ky ishte shpjegimi për dobitë, vlerën e lartë dhe nijetin e udhëtimit.

Pjesa e dytë

RREGULLAT E SJELLJES (ADABI) I UDHËTARIT, NGA NISJA DERI NË KTHIM

Janë njëmbëdhejtë adabe (rregulla të sjelljes):

1. Personi që do të udhëtojë, fillimisht duhet të paguajë hakun nëse i ka hyrë në hak dikujt, nëse ka borxh ta kthejë borxhin dhe të sigurojë strehim, ushqim, veshje, etj; për ata qëi ka obligim. E me vete duhet të marrë vetëm gjëra hallall dhe të pastra, aq sa do t'i mjaftonin për vete, e edhe të ndajë me bashkëudhëtarët. Ibn Omeri r.a., ka thënë:

“Një nga shenjat e nderit është që udhëtari në rrugë merr me vete vetëm furnizim të lejuar.”

Në udhëtim duhen bisedat e këndshme, ndarja e ushqimit dhe sjellja e mirë ndaj bashkëudhëtarëve. Ai që ka sjellje të mirë me shokët në udhëtim, ai ka sjellje të mirë edhe në shtëpi. Ka edhe të tillë që kanë sjellje të mirë me shokët kur janë në vendin e vet, por jo edhe gjatë udhëtimit. Prandaj është thënë:

“Personi me të cilin tregton, e të bëhet shok edhe në udhëtim, mos dysho në mirësinë e tij.”

Udhëtimi është një prej shkaktarëve të nervozës, pakënaqësisë, prandaj ai që edhe kur është nervoz mbetet me ahlak të mirë, vërtetë është me natyrë të mirë. E keqja vështirë që shfaqet kur gjithçka është për qejfi dhe asgjë nuk pengon. Është thënë:

“Tre persona nuk duhet qortuar kur janë me disponim të keq: agjëruesin, të sëmurin dhe udhëtarin.”

Ahlaku i mirëi udhëtarit është mirëbërja ndaj bashkudhëtarit, kujdesi për devenë, ndihmesa shokëve, mirëkuptim për ata që mbesin mbrapa, dhe të mos tejkalojë shokun, pos nëse dëshiron t’i ndihmojë, t’i japë diçka ose të ndalet për hatër të tij. Dhe e gjitha kjo, në shoqëri më së lehti arrihet përmes shakasë dhe bisedës në momente të caktuara, por pa asgjë të pahijshme ose të palejuar. Sjellja e tillë bën të harrohet lodhja dhe vështirësitë në udhëtim.

2. Udhëtari duhet të zgjedhë bashkudhëtarin. Le të mos niset i vetëm në rrugë. *Shoku, pastaj udha*. Shoku le të jetë i tillë që do ta ndihmojë në fenë e tij, që do ta përkujtojë kur të harrojë, dhe do t’i ndihmojë kur duhet. *Njeriu është në fenë e shokut të vet*. Secili njihet përmes shokut të vet.

Resulallahu s.a.v.s., ka ndaluar që njeriu të udhëtojë i vetëm⁸, e gjithashtu ka thënë:

“Duhet të jenë tre vetë.”⁹

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Nëse në rrugë jeni tre persona, njërën caktojeni përfaqësues!”¹⁰

As’habët kështu edhe vepronin, duke thënë: *“Ky është përfaqësuesi (vekili) jonë, të cilin e ka urdhëruar Resulallahu s.a.v.s..”*

Përfaqësuesi (vekili) i zgjedhur duhet të jetë me ahlak të bukur, të ndihmojë bashkudhëtarin, t’i japë përparësi tjetrit dhe të dëgjojë të tjerët. Ai nevojitet në udhëtim për të parandaluar mosmarrëveshjet e mundshme për vend-pushimet, për caktimin e rrugës dhe çështje tjera që lidhen me udhëtimin. Sepse mendimet do të jenë të ndryshme, e vekili vendos. Rendi është në bashkësi, e përçarja në shumësi. Edhe në gjithësi ka rend sepse ka Një drejtues. E në ajet thuhet:

“Sikur në qiej e në Tokë të kishte zota të tjerë, përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të shkatërroheshin.” 21-Enbija: 22

⁸ Hadithin e shënon Ahmedi nga Ibn Omeri me zingjir të besueshëm të transmetuesve, e hadith të ngjashëm përcjellë edhe Buhariu.

⁹ Hadithi i shënuar në *Vasijjetname*-n e njohur të hazreti Alisë r.a., dhe konsiderohet hadith i njohur.

¹⁰ Shënon Taberani nga Ibn Mesud me zingjir të mirë të transmetuesve.

Deri sa të jetë një drejtues, edhe parandalimi është i mundur, e sa herë të ketë më shumë drejtues, punët do të prishen, si në shtëpi njëjtë edhe në udhëtim, me atë që *shtëpia* (vendbanimi) ka një udhëheqës të përgjithshëm, si për shembull kryetari i shtetit, ose i zoti i shtëpisë. E në udhëtim, përfaqësuesin e zgjedhin udhëtarët nga mesi i tyre. Zgjedhja e përfaqësuesit nga udhëtarët është bërë vaxhib me qëllim që të bashkohen mendimet e ndryshme. Obligim i përfaqësuesit është të kërkojë vetëm atë që është në dobi të të gjithë bashkëudhëtarëve dhe që veten ta bëjë mbrojtës të tyre.

Abdullah Merveziu tregon se një herë deshi të udhëtonte me Ebu Ali Ribatin, dhe e pyeti se cili të bëhet vekil i rrugës. "*Bëhu ti*", i tha Alia, e Abdullahu i ngarkoi në shpinë edhe gjësendet e veta edhe ato të Alisë, e i barti ato gjatë gjithë rrugës. Një natë filloi të bie shi, e Abdullahu e kaloi gjithë natën i kërrusur mbi kokën e shokut të tij të rrugës, duke i mbajtur mbulojë mbi kokë, të mos e lagë shiu.

Sa herë që Ebu Alia i thoshte: "*Mos bëj kështu!*", Abdullahu përgjigjej:

- *A nuk më pranove mua vekil? Mos më kundërshto, dhe mos e shkel fjalën e dhënë!*

Më vonë, Ebu Alia pat thënë:

- *Sikur të kisha vdekur, e të mos i kisha thënë të bëhet ai vekil.*

Pra kështu duhet të jetë vekili! E Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Shoqëria më e mirë është katër persona.”¹¹

Sigurisht që në caktimin e numrit katër ka hikmet. Me këtë numër, udhëtarit gjithmonë i jepet mundësia të kujdeset për dikë ose të ndihmojë në diçka. Po të ishin tre, njëri do të mbetej anash dhe nuk do të kishte shoqërues, që gjithsesi do ta mërziste, pasi do t'i mungonte afërsia e tjetrit. Sikur me ndonjë nevojë të merren dy prej tyre, njëri do të mbetej vetëm, e prapë nuk do të ishte i kursyer nga mërzia.

Për këtë arsye, më pak se katër nuk e plotëson kushtin, e më shumë se katër është tepër, sepse nuk do t'i lidhte një fije, e as që mes tyre do të zhvillohej shoqëri e vërtetë, pasi që i pesti do të ishte shtim në të mjaftueshmen. Ai që nuk do të ketë nevojë për të, as nuk do t'i kushtojë vëmendjen, prandaj edhe nuk do të kishte shoqërim. Natyrisht, dobia e shoqërisë së madhe është në siguri nga rreziqet e mundshme. Megjithatë, katër është numër më i mirë për shoqëri të veçantë, jo atë të përgjithshme. Sa e sa ka shokë në shoqëri të mëdha, të cilët gjatë gjithë rrugës nuk flasin me kë e as që kanë ndonjë kontakt deri në fund të udhëtimit, pasi që askush nuk ka nevojë për ta!

¹¹ Ebu Davud, Tirmidhiu dhe Hakimi, nga Ibn Abbas. Sipas Tirmidhiut, hadithi është *hasen garib*, deri sa Hakimi thotë se është *sahih* (i besueshëm), sipas Buhariut dhe Muslimit.

3. Udhëtari duhet t'i japë lamtumirën familjes, të afërmve, komshive e shokëve dhe të bëhet duaja që e ka bërë Resulallahu s.a.v.s.. Dikush ka treguar:

“Po udhëtoja bashkë me Ibn Omerin r.a., nga Meka në Medine, Allahu e ruajtë. Kur desha të ndahem prej tij, ai më përcolli, e më tha:

- E kam dëgjuar Resulallahun s.a.v.s., të thotë:

*- **Llukmani ka thënë:***

Allahu Teala e ruan amanetin, kur i jepet.

Edhe unë po i lë amanet Allahut mallin tënd, fenë tënde dhe përfundimin e veprave tua.¹²

Zejd ibn Erkan tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kur dikush nga ju të niset për rrugë, e i jep lamtumirën shokëvetë vet, vërtetë që Allahu Teala në duatë e tyre do të krijojë bereqet për ata.”¹³

Amr ibn Shuajb tregon nga i ati, e ky nga gjyshi i vet, se Resulallahu s.a.v.s., kështu e përshëndeste udhëtarin:

“Allahu të dhuroftë takvallëk, gjynahet t'i faltë e në hajr të udhëzofte, kah do që të nisesesh!”¹⁴

¹² Shënon Nesai, në *‘El-Jevm ve’l-Lejle’* si edhe Ebu Davud në formë më të shkurtë dhe me zingjir të mire të transmetuesve.

¹³ Haraiti, në *‘Mekarimul Ahlak’* me zingjir të dobët të transmetuesve.

¹⁴ Haraiti në *‘Mekarimul Ahlak’* dhe Muhamili në *‘Dua’*.

Kjo është dua ja të cilën ai që qëndron në vend ia thotë atij që udhëton. E Musa ibn Virdan tregon:

“Erdha një herë te Ebu Hurejre për t’ia dhënë lamtumirën, para udhëtimit, e ai më tha:

- O i dashur, a të mësoj diçka që më ka mësuar Resulallahu s.a.v.s., për lamtumirën ?

- Natyrisht!, iu përgjigja. E ai tha:

*- **Po të lë në amanet Allahut, e Ai assesi nuk e humb amanetin.***¹⁵

Nga Enes ibn Malik r.a., tregohet se një njeri erdhi te Resulallahu s.a.v.s., dhe iu drejtua:

- Po nisem për rrugë; më mëso diçka, e Resulallahu s.a.v.s., i tha:

*- **Qofsh në mbrojtje të Allahut e nën kujdesin e Tij! Allahu të dhuroftë takvallëk, gjynahet t’i faltë e në hajr të udhëztoftë, kah do që të nisesh (apo të jesh)***¹⁶

Kur i len në amanet Allahut atë çfarë po lë mbrapa, le ta bëjë këtë për të gjithë.

Transmetohet nga hazreti Omeri r.a., se si një herë, deri sa po ju ndante njerëzve atë që ju takon, i erdhi një njeri me të birin. Omeri r.a., i tha:

¹⁵ Ibn Maxhe dhe Nesai në *‘El-Jevm ve’l-Lejle’* me zingjir të mirë të transmetuesve.

¹⁶Hadithin e kemi përmendur në *Librin e haxhit*.

- Kurrë nuk kam parë dikë t'i përngjajë tjetrit, sikur ky fëmijë ty!,

e personi ia ktheu:

- O prijës i muminëve, të tregoj diçka:

Një herë desha të nisem për rrugë, e nëna e tij ishte shtatzënë me të, e më tha:

- Vallë po shkon e po më lë në këtë gjendje?! e unë iu përgjigja:

- Allahut ia lë amanet atë që është në stomakun tënd, e u nisa për rrugë.

Kur u ktheva, gruja kishte vdekur. U ulëm të flasim për këtë me komshitë kur te varri i saj u lajmërua një pishtar!

I pyeta komshitë se çfarë është ajo, e më thanë:

- Është një pishtar që lajmërohet prej varrit. Lajmërohet për çdo natë. Ju thashë:

- Pasha Allahun, ajo ka falë shumë namaz, dhe shumë ka agjëruar. E mora krampën e u nisëm te varri i saj. Filluam të gropojmë, kur u lajmërua një dritë, dhe ky djalë doli prej aty! Dëgjova një zë që tha:

- Merre; ky është ai amaneti yt. Po t'ia lëje edhe nënën e tij ashtu amanet Allahut, edhe atë do ta gjeje gjallë.

E në këtë, hazreti Omeri r.a., i tha:

- Vallahi më shumë të përngjanë ky ty, se sorra sorrës.

4. Para se të niset për rrugë, të falë namaz istihare, siç e kemi shpjeguar në *Librin e fshtehtësive të namazit*, dhe dy reqate namaz të udhëtimit t'i falë kur të niset.

Enes ibn Malik r.a., tregon se si një njeri kishte ardhur te Resulallahu s.a.v.s., e i kishte thënë:

- *Kam vendosur të nisem për rrugë, dhe tashmë e kam shkruar testamentin (vasijetname), prandaj kujt t'ia lë atë: djalit, vëllait apo babasë?"*

Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- **Nuk ka përfaqësues më të dashur për Allahun që robi mund të lë në shtëpi se sa katër reqate që do t'i falë aty kur të bëhet gati për rrugë, duke lexuar në cdo reqat *Fatiha* dhe *Kulhuvallahu ehad*, e më pas të thotë:**

"O Allah, këtë namaz e fala për rizanë Tënde, ruaje familjen dhe pronën time",

dhe kjo i bëhet shkak që ta ruajë familjen dhe pronën deri sa të kthehet.¹⁷

5. Kur vjen te pragu i shtëpisë, le të thotë:

Me emrin e Allahut tek Allahu mbështetem, nuk ka fuqi, përpos Allahut! O Rabbi im, tek Ti strehohem që të mos devijoj e të mos më devijojnë, që të mos nxis në gjynah e të mos më nxisin në gjynah, që të mos bëj zullum (dhunë) e të mos jem mazllum (kujt i bëhet dhunë), që të mos udhëzoj në mosdije, e të mos udhëzohem në mosdije!

¹⁷ Haraiti, në *'Mekarimul Ahlak'*

Kur niset në rrugë, le të thotë:

O Allah, me ndihmën Tënde po nisem, tek Ti mbështetem, Ty të besoj dhe kah Ti kthehem. O Allah, ti je siguria ime, shpresa ime; prandaj më ndihmo në çdo vështirësi, edhe nga ajo që Ti e di më mirë se unë. Mbrojtës i fuqishëm je Ti dhe madhështor je Ti, falënderimet të takojnë Ty! Nuk ka zot pos Teje! O Allah, më furnizo me takvallëk, m'i fal gjynahet dhe më udhëzo në hair, ngado që të nisem!

Këtë dua le t'a thotë edhe kur fillon rrugë nga ndonjë bujtinë. E kur hip në mjet të udhëtimit, të lexojë:

Me emrin e Allahut, filloj me Allahun, Allahu është më i madhi! U mbështeta tek Allahu, nuk ka forcë pos Allahut Teala. Çka do Allahu, ajo bëhet, e çka nuk do Allahu, nuk bëhet. **Qoftë lavdëruar Ai që i nënshtroi këto për ne, se, na këto, vetë nuk do të mund t'i arrinim - dhe ne, me siguri, do të kthehemi te Rabbi ynë!** (43-Zuhruf: 13, 14)

Kur vendoset në mjetin transportues, të lexojë:

Qoftë lavdëruar Allahu që na udhëzoi në këtë. Ne nuk do të ishim udhëzuar, sikur të mos na udhëzonte Allahu. (7-Araf: 43). *O Allah, Ti je Ai që më bartë mua në këtë mjet udhëtimit, dhe prej Teje kërkohet ndihma, për të gjitha!*

6. Udhëtari duhet që në rrugë të niset herët në mëngjes. Nga Xhabiri r.a., transmetohet se Resulallahu s.a.v.s., u nis për në Tebuk të enjten herët në mëngjes, duke thënë:

“O Allah, bekoje ummetin tim në punët e tyre të hershme!”¹⁸

Është *mustehab* (e lavdërueshme) që nisja për rrugë të bëhet të enjteve. Abdullah ibn Ka’b ibn Malik transmeton nga babai i vet se rrallë ka ndodhë që Resulallahu s.a.v.s., të niset për rrugë ndonjë ditë tjetër pos të enjtes. Ndërsa Enesi r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s. ka bërë dua:

O Allah, bekoje ummetin tim që nisin herët të shtunave!

Edhe kur niste ekip për ndonjë detyrë të veçantë, Resulallahu s.a.v.s, i niste herët në mëngjes. Ebu Hurejre r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka bërë dua:

“O Allah, bekoje ummetin tim në nisjen e tyre të hershme të enjteve!”¹⁹

Abdullah ibn Abbas ka thënë: *“Kur ke punë me dikë, mos e bëj natën por bëje në mëngjes. E kam dëgjuar Resulallahun s.a.v.s., kur tha:*

“O Allah, bekoje ummetin tim në punët e tyre të hershme!”²⁰

¹⁸ Haraiti në *‘Sunen-i Erba’* nga Amiri.

¹⁹ Ibn Maxhe dhe Haraiti, në *‘Mekarim-i Ahlak’*

²⁰ Bezzari, Taberani në *el-Kebir* dhe Haraiti, në *‘Mekarimul Ahlak’*

Ditën e xhumasë, mos të niset në rrugë pas lindjes së diellit, që të mos humbasë namazin e xhumasë e të bëj xhynah. Pasi që dita filon me sabah, koha e sabahut bëhet sepse që namazi i xhumasë të bëhet i obligueshëm.

Edhe përcjellja e udhëtarit është *mustehab*. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Më e dashur për mua është që të përcjelli me përqaftim luftëtarin në rrugën e Allahut e t’i ndihmoj kur niset e kur kthehet, se sa i gjithë dynjallëku, me krejt çka ka.”²¹

7. Të mos ndalet në rrugë për pushim deri sa dielli të fillojë të ngrohë. Ky është sunnet.

Zakonisht udhëtohet natën ngase Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Nisuni në udhëtim para sabahut.”²²,
e natën (në fllad) kalohet më shumë se ditën.

Sa herë t’i afrohet konakut, le të bëjë dua:

O Allah, Rabb i shtatë qiejve e çka ata përmbajnë, Rabb i shtatë tokave e çka ato bartin, Rabb i shejtanit e me çka ai mashtron, Rabb i erërave e çka ato vringëllojnë, Rabb i detit e çka ai mbanë, të lus Ty për

²¹ Ibn Maxhe nga Muaz ibn Enesi.

²² Hadithin e kemi përmendur në *Librin e të fshehtave të haxhit*.

mirësi prej këtij vendi dhe banorëve të tij, e tek Ti strehohem nga e keqja e këtij vendi dhe banorëve të tij. Largo prej meje të keqen e keqbërësve të këtij vendi!

Kur të vendoset në konak, le t'i falë dy reqate namaz e le të lexojë:

O Allahu im, për nder të të gjitha fjalëve Tua, tek Ti strehohem nga e keqja që ke krijuar.

Kur të flejë natën le të lexojë:

Oj Tokë, Rabb i imi e i joti është Allahu! Tek Allahu strehohem nga e keqja e secilës bishë dhe keqbërës, gjarpër dhe akrep, nga e keqja e banorëve të këtij qyteti, nga të lindurit dhe ajo çka ata lindin.

“Vetëm e Tij është gjithçka që pushon e lëviz natën e ditën. Ai gjithçka dëgjon dhe gjithçka di.”

(6-Enamë: 13).

Kurdo që gjatë udhëtimit të ngritet në ndonjë lartësi (vend të lavdueshëm), le të lexojë:

O Allahu im, lavdi për Ty në secilën lartësi dhe hamd (falënderim) Ty në secilën gjendje!

Sa herë të zbresë, le të bëj *tespîh* ‘**subhanallah**’, e sa herë që në rrugë ta kaplojë frika, le të lexojë:

Lavdi Sundimtarit më të Shejtë, Rabbit të melekëve dhe ruhît, (shpirtit)! Me gjithëfuqinë Tënde qijet janë lartësuar.

8. Të ruhet gjatë ditës. Të mos ndahet nga karvani, sepse mund të dëmtohet ose të humbasë rrugën. E gjatë natës, prapë le të ruhet mirë! Resulallahu s.a.v.s., kur ishte në udhëtim e shtrihej për gjumë në fillim të natës, do t'i zgjaste këmbët, e nëse do të flinte kah fundi i natës, atëherë do të mblidhte këmbët dhe do të vendoste kokën mes duarve. Arsye për një veprim të këtillë është që të mos thellohet në gjumë, e të zgjohet për namazin e sabahut.

E lavdërueshme (mustehab) është edhe kur gjatë natës bashkëudhëtarët bëjnë roje me radhë. Kur njëri fle, tjetri bën rojë. Kjo është sunnet. Nëse i vërsulet ndonjë armik apo bishë, le të lexojë *Ajetul-kursijj*, *Shehidallahu*, suren *Ihlas*, *Felek* dhe *Nas*, dhe le të lexojë:

Me emrin e Allahut, ndodh ajo që do Allahu! Nuk ka fuqi, pos me Allahun, më mjafton Allahu, tek Allahu mbështetem, vetëm Allahu sjellë të mirën, ndodh ajo që do Allahu! Vetëm Allahu e largon të keqen, mua më mjafton Allahu. Allahu dëgjon atë që lutet! Askush nuk është më i madh se Allahu, e as nuk ka strehim pos te Ai!

“Allahu ka vendosur: Unë dhe të dërguarit e Mi do të triumfojmë me siguri! Allahu është vërtet i Fortë dhe i Plotfuqishëm.”(58: Muxhadele: 21).

Unë dëshmoj që Allahu Teala është i Plotfuqishmi, dhe ndihmë kërkoj nga i Gjalli, i Përhershmi, Ai që nuk vdes. Allah, na ruaj me syrin Tënd i cili nuk fle, dhe na

mbroj me mbështetjen Tënde, që është e pafund. Allah, bëj rahmet me fuqinë Tënde që të mos dëmtohem. Ti je mbështjetja dhe shpresa jonë. Allah, zbuti zemrat e robëve e robëreshave tua, me mirësinë e rahmetit Tënd. Vërtetë, Ti je Rahman e Rahim!

9. Të jetë i butë ndaj kalit, nëse kalëron. Mos ta ngarkojë më shumë se që kali mund të bartë. Mos ta godasë në kokë sepse kjo është e ndaluar. Mos të flejë hipur në të, sepse kjo e bën gjumin e rëndë dhe e shqetëson kalin. Besimtarët nuk kanë fjetur hipur mbi kalë, por vetëm do të mbështeteshin. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Mos e bëni shpinën e kafshës shtrat!”²³

Është mirë që të zbritet nga kafsha në mëngjes dhe në mbrëmje, që kafsha të pushojë. Ky është sunnet, si edhe traditë te selefët (të parët e ndershëm). Disa prej tyre do të huazonin kafshë transporti vetëm me kusht që të mos kenë nevojë të zbresin nga kafsha, dhe shumë do ta paguanin të plotë.

E më pas, megjithatë do të zbrisnin nga kafsha, që të jenë të mirë ndaj saj dhe kështu shtonin veprat e veta të mira, e jo të atij që ka dhënë kafshën me qira. Ai që shqetëson kafshën, qoftë me të goditura apo me

²³ Hadithin e kemi përmendur në *Librin e fshehtësive të haxhit*.

ngarkesë më të rëndë se që kafsha mund të bartë, do të pyetet në ditën e gjykimit. Llogaria do të jepet për secilën vështirësi të bërë. Ebu Derda r.a., në momentin e vdekjes, i fliste deves së tij:

“Oj deve, mos më akuzo nesër para Allahut, sepse nuk të kam ngarkuar më shumë se që mundesh.”

Të zbritet nga kafsha për vetëm një orë, i ka dy sadaka: pushimi për kafshën dhe gëzimi i zemrës së atij që e ka dhënë kafshën me qira. Ka edhe dobinë e tretë, që janë ushtrimet trupore për udhëtarin, lëvizja e këmbëve dhe pengimi i mpirjes së trupit nga kalërimi i gjatë. Me atë që jep kafshën me qira duhet pajtuar çka do të ngarkohet në kafshë, një nga një. Kjo t’i tregohet.

Kafsha të huazohet me marrëveshje të ligjshme, që të mos vije deri te mosmarrëveshjet e kjo të shkaktojë shqetësim në zemër, të detyrojë në fjalë të ndryshme dhe të nxisë përleshje me huadhënësin.

Udhëtari nuk do të duhej të ngarkojë kafshën përtej marrëveshjes, qoftë kjo edhe pak, sepse e pakëta tërheq me vete edhe të shumtën. Kush sillet rreth gropës, shpejt mund edhe të bjerë në të. Ibnul-Mubareku po kalëronte, e dikush i tha:

- *Merre këtë letër e dërgoja filanit, në çka Ibn Mubarek u përgjigj:*

- *Së pari më duhet ta pyes pronarin e kafshës, sepse nuk kam bërë marrëveshje për bartje të letrës.*

Shih si nuk është bazuar në zgjedhjet e fakihëve, të cilët thonë se diçka e tillë mund të tolerohet, por ka zgjedhur shkallën më të lartë të devotshmërisë (*vera*).

10. Udhëtari me vete duhet marrë gjashtë gjëra. Hazreti Ajsha r.anha., tregon se Resulallahu s.a.v.s., në rrugë merrte pesë gjëra: pasqyrën, surmedanin (lyerësin e qerpikëve), gërshërët, misvakun dhe krehërin, ndërsa në një transmetim tjetër përmenden gjashtë gjëra: pasqyra, surmedani, gërshërët, misvaku, parfumi dhe krehëri.

Ummu Sa'd el-Ensarije tregon se Resulallahu s.a.v.s., në rrugë nuk ndahej nga pasqyra dhe surmedani. Suhejb tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kur të shtriheni për të fjetur përdorni surmen e zezë, sepse ajo shton shikimin dhe ruan qerpikët.”²⁴

Transmetohet se Resulallahu s.a.v.s., surmen e tërhiqte tri herë, e në transmetim tjetër thuhet tri herë rreth syrit të djathtë, e dy herë rreth të majtit.

Në gjithë këtë, në udhëtim sufite e shtojnë edhe ibrikun dhe litarin, duke e konsideruar si të nevojshëm. Një sufi thotë se nëse besimtari i varfër nuk ka ibrik e litar, kjo tregon mangësinë e besimit të tij. Me demek,

²⁴ Haraiti në **‘Mekarimul Ahlak’** ndërsa gjendet edhe te Tirmidhiu. Ibn Huzejme dhe Ibn Hibban e llogarisin si sahih-hadith nga Ibn Abbasi r.a., e të besueshëm e konsideron edhe Ibn Abdulberr dhe Hattabi thotë se ka sened është sahih.

këtë e kanë shtuar si masë mbrojtëse lidhur me pastrimin me ujë, të trupit dhe rrobave. Ibriku do t'i shërbejë për ruajtje të ujit të pastër, ndërsa litari për nxjerrje të ujit nga bunaret si edhe për tharje të rrobave të lara. Megjithatë, gjeneratat e para kur nuk kanë gjetur ujë, janë mjaftuar me tejemmum dhe e kanë konsiduar të panevojshme bartjen e ujit. Atyre nuk u pengonte të marrin abdest në ndonjë pellg apo kënetë të vogël, përderisa uji ishte i pastër. Vet hazreti Omeri r.a., një herë pat marrë abdest nga një ibrik i të krishterëve. Toka dhe faqet e kodrinave ju zëvendësonin litarin, rrobat e lara do t'i shtrinin në këso vende.

Ibriku është *bidat* (risi), por është *bidat hasene* (risi e lavdëruar). *Bidat mezmume* (risi e qortuar) është bidati që është në kundërshtim të plotë me sunnetin. Ajo që ndihmon në ruajtjen e fesë është e lavdëruar.

Për teprimin në pastërti tashmë kemi folë në *Librin e fshehtësive të pastërtisë*. Ai që ka kujdes në çështje të fesë nuk guxon të zgjedhë rrugën e lehtësimeve, por duhet të ketë kujdes për pastërtinë, përderisa kjo nuk e largon nga punët më të dobishme. Tregohet se Havasi ishte nga ata që plotësisht mbështeten tek Allahu Teala. Nga katër gjëra nuk ndahej, as në rrugë e as në shtëpi: nga ibrik, litari, gjilpëra me fije dhe gërshtëret, e thoshte:

“Këto nuk janë gjësende të dynjasë.”

11. Kur Resulallahu s.a.v.s., kthehej nga beteja, haxhi, umreja ose ndonjë udhëtim tjetër, në secilën kodrinë bënte *tekbir*²⁵ tri herë, duke thënë:

“Nuk ka ilah pos Allahut, e Ai nuk ka ortak. Atij i takon pushteti dhe falënderimet, dhe Ai është në gjendje të bëj çka do. Pendohemi, Atij i bëjmë ibadet dhe sexhde, i jemi falënderues Rabbit tonë. Ai e mbajti premtimin e Tij, e ndihmoi robin e Tij.”

Kur të mbërrijë para qytetit të vet, le të lexojë:

“O Allahu im, na e bëj qytetin të sigurt e me furnizim të mirë.”

Më pas le të dërgojë dikë në shtëpinë e vet që t’i njoftojë familjen për mbërritjen e tij, që të mos vij papritmas e të gjejë diçka që nuk i pëlqen. Gjithashtu, nuk guxon të kthehet në shtëpi gjatë natës. Për diçka të këtillë ka ndalesë. Kur mbërrinte në qytet, Resulallahu s.a.v.s., së pari do të shkonte në xhami e do t’i falte dy reqate namaz, e vetëm pas kësaj shkonte në shtëpi. Kur hynte, thoshte:

“Teube bëj, teube bëj o Rabbi ynë, pendohem, pendohem, secilin gjynah tonin Ti e di!”²⁶

²⁵ Hadithin e kemi përmendur në *Librin e fshehtësive të haxhit*.

²⁶ Ibnus-Sunni në *‘El-Jevm ve’l-Lejle’* dhe Hakimi nga Ibn Abbasi. Hakimi thotë se hadithi është i besueshëm sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit.

Familjes dhe të afërmve do të duhej të ju sjell ndonjë dhuratë, qoftë nga ushqimi ose diçka tjetër, aq sa ka mundësi. Ky është sunnet. Transmetohet se, nëse njeriu nuk ka asgjë në rast të këtillë, së paku le të vendosë një gur në shami. Kështu, në mënyrë të theksuar inkurajohet këso lloj kujdesi, sepse sytë janë kah ai që kthehet prej rrugës, e zemrat i gëzohen. Është e lavdërueshme që t'i gëzojë e t'ju tregojë se gjatë udhëtimit ka menduar për ta.

Ky ishte adabi i jashtëm në udhëtim.

Sa për adabin e brendshëm, për këtë shpjeguar hollësisht në pjesën e parë. Thelbi është që njeriu të mos udhëtojë, nëse kjo nuk ia forcon besimin. Sa herë që në zemërtë ndjejë ndryshim për të keq, le të ndalet e le të kthehet në shtëpi. Gjithashtu, mos të vendoset atje ku do të kishte telashe, por aty ku do të ndihet mirë.

Kur të hyjë në një qytet, le ta ketë për qëllim që aty të takojë shehlerët, të mundohet të përfitojë nga dituria dhe edukimi i tyre, që këtë t'ua përcjellë të tjerëve, e jo që më pas të lavdërohet që është takuar me ta.

Mos të qëndrojë në një vend më gjatë se një javë, ose dhjetë ditë, pos nëse shejhu te i cili ka shkuar nuk e urdhëron ndryshe.

Deri sa të qëndrojnë atje le të shoqërohet vetëm me të sinqertit dhe të thjeshtit. Nëse i shkon në vizitë ndonjë vëllau të vet, mos të qëndrojnë më gjatë se tri ditë. Ky është kufiri sa mund të qëndrohet mysafir, pos nëse largimi i tij do t'i vinte shumë rënd vëllait atëherë të qëndrojnë më shumë.

E nëse shkon te shejhu, te ai mos të qëndrojnë më gjatë se një ditë e një natë, dhe të mos lëshohet në biseda të kota me njerëz, sepse kjo e dëmton bereqetin e udhëtimit të tij.

Sa herë të hyj në një qytet me qëllimin e vetëm që të vizitohesh një shejh të caktuar në shtëpinë e tij, nëse shejhu është në shtëpi, të mos i trokasësh në derë e as mos të kërkojë leje për të hyrë, deri sa shejhu vet nuk del. Kur shejhu del, le t'i afrohet dhe me respekt t'i japësh selam. Para tij mos të flasësh asgjë, pos nëse ai e pyet. Nëse shejhu pyet, ky do të përgjigjet vetëm aq sa është pyetur. Nuk do t'i parashtrijësh kurrfarë pyetje para se të kërkojë leje për këtë. Nuk duhet të flasësh për udhëtimin, për ushqimet nga vendet që ka vizituar, as për fisnikët e shokët e tij në ato vende.

Le të flasësh për shehlerët dhe besimtarët modestë, që atje i ka takuar. Në udhëtime të mos lësh vizitën varreve të njerëzve të mirë. Në fakt, duhet t'i kërkojë, në secilin vend që shkon. Dhe mos të shfaqësh nevojat e tij, përpos aq sa është e domosdoshme, dhe vetëm atij që mund t'i ndihmojë.

Gjatë udhëtimit, le t'i përmbahet dhikrit dhe leximit të Kur'anit, aq sa të mos dëgjojnë të tjerët. Nëse i drejtohet dikush, le ta ndërpresë dhikrin e të përgjigjet. Më pas le të vazhdojë atje ku ka mbetur me dhikr.

Kur të lodhet nga udhëtimi ose nga qëndrimi në një vend, mos t'i përshtatet dëshirave e nefsit por le t'i kundërshtojë ato. Kundërshtimii nefsit është bereqet.

Nëse i jepet rasti t'ju bëj hizmet (t'ju shërbejë) njerëzve të mirë, atëherë nuk duhet të udhëtojë e të mundohet për të bërë hizmet diku tjetër. Kjo do të ishte përbuzje e të mirës. E, sa herë që i duket vetja më i keq se para udhëtimit, le ta dijë se udhëtimi i është me të meta, prandaj le të kthehet, sepse po të ishte në rrugë të drejtë, do t'i shihte gjurmët.

Një njeri i tha Ebu Osman Magribit:

- *Filani u nis për rrugë, e Osmani iu përgjigj:*

- *Udhëtimi është kurbet e kurbeti poshtërim. Nuk është e drejtë që myslimani ta poshtërojë veten.*

Me këtë ka treguar se ai që me udhëtimin e vet nuk e forcon fenë, në fakt po e poshtëron veten.

Prandaj, udhëtimi i muridit duhet të jetë për largimin e adeteve, dëshirave dhe hireve të veta, që në atë vend të huaj të ngritet, e jo të poshtërohet. Përndryshe, ai që në udhëtim jepet pas dëshirave të veta, padyshim që në fund do të poshtërohet, në këtë botë (dynja) ose në ahiret.

Kapitulli i dytë

SHPJEGIMI PËRÇËSHTJET QË DUHET TË DIHEN PËR LEHTËSIMET E UDHËTIMIT, SHENJAT E KIBLËS DHE KOHËT E NAMAZIT

Dije se, udhëtari duhet të furnizohet; si për dynjallëk, ashtu edhe për ahiret, qysh në fillim të udhëtimit të tij.

Furnizim për dynjallëk janë ushqimi, uji dhe nevojat tjera. Por, mund të udhëtohet edhe pa furnizim, nëse është me karvan ose mes dy vendeve të afërta, e duke u mbështetur Allahut.

Nëse niset vet, ose edhe shokët nuk kanë as ushqim as ujë me vete dhe në atë rrugë nuk gjinden fshatra, atëherë shikohet se a është ky person që duron urinë me ditë të tëra, ose i mjafton të ushqehet vetëm me bimë, e atëherë mund të niset.

Por, nëse nuk e ka një sabër të këtillë kur është i uritur, ose nuk mjaftohet vetëm me bar, atëherë një nisje e këtillë për rrugë do të ishte gjynah, sepse kështu me duar të veta e hedh veten në shkatërrim. Kjo çështje e ka edhe një fshehtësi të veten, për të cilën do të flasim në *Librin e Tevekkulit*.

Kuptimi i *tevekkulit* (mbështetja Allahut) nuk është heqja dorë nga plotësimi i nevojave. Po të ishte ashtu, atëherë *tevekkuli* do të humbaste kuptimin e vet sapo të kërkohet një ibrik apo litar i thjeshtë, apo të nxjerrjet ujë nga bunari. I tilli do të priste që Allahu t'i dërgojë ndonjë melek apo njeri, që t'i lëshojë ujin në gojë. Prandaj, nëse posedimi i ibrikut e litarit - veglave me të cilat furnizohemi me ujë - nuk ia humb kuptimin *tevekkulit*, atëherë nuk kundërshton *tevekkulin* as bartja e ushqimit dhe ujit. Për hakikatin e *tevekkulit* do të flasim më shumë në vend të përshtatshëm. Ajo çështje është mjaft e paqartë për të gjithë, përpos për dijetarët e kompletuar.

E furnizim për ahiret është njohja e çështjeve të pastrimit, agjërimit, namazit dhe ibadetit.

Udhëtimi nganjëherë bën që disa çështje t'i lehtësohen, siç është shkurtimi i namazit, bashkimi i tyre dhe mos-agjërimi, prandaj duhet t'i dijë lehtësimet për vete. Por nganjëherë disa çështje komplikohen, siç është gjetja e drejtimit të kiblës dhe kohët e namazit. Në vendin e vet i ka mjaftuar orientimi me xhami dhe dëgjimi i ezanit për kohën, por në udhëtim i duhet që këto t'i dijë vet.

Prandaj, gjërat që udhëtari duhet t'i dijë ndahen në dy pjesë.

Pjesa e parë
NJOHJA E LEHTËSIMEVE NË UDHËTIM

Me udhëtim hapen dy lehtësime në pastrim: mes'hi mbi mest'et (lëmim me dorë të lagur mbi mest'et - mbathjet e lëkurës) dhe tejemmumi; dy lehtësime në namazet farz: shkurtimi dhe bashkimi i tyre; dy lehtësime në namazet nafile: falja gjatë ecjes dhe falja në deve (mjet transporti), si edhe një lehtësim në agjërim - ndërprerja e tij. Pra, gjithsejt janë shtatë lehtësime:

Lehtësimi i parë

Mes'hi mbi meste. Safvan ibn Assal tregon:

“Resulallahu s.a.v.s., na ka urdhëruar që, kur të jemi në rrugë, mos t'i zbathim mestet tri ditë e tri netë.”

Kur i mbathë mestet sa është me abdes, e pas kësaj i prishet abdesi, ai mund të bëjë *mes'h* mbi meste tri ditë e tri netë (72 orë) nga momenti kur e prish abdesin, nëse është udhëtar, e nëse aty banon, një ditë e një natë. (24 orë, pra pesëkohët e namazeve farz).

Por mes'hi mbi meset ka pesë kushte:

1. Mestet t'i mbathë pas marrjes së abdesit.²⁷

²⁷Sipas medh'hebit Hanefi është e pranueshme (xhaiz) nëse pas larjes së këmbëve mbathë mestet dha pastaj vazhdon të lajë pjesët tjera.

2. Mestet të jenë të forta, që me to të mund të ecet. Mes'h mund të bëhet edhe në mestet me të cilat nuk mund të ecësh në rrugë, sepse është e zakonshme që me to të ecet brenda në shtëpi, e zakonisht edhe janë të forta. Megjithatë, mes'hi nuk është i lejuar mbi *çorapat e leshta*²⁸, e as mbi opanga.

3. Mestet të mos jenë të grisura. Nëse janë të grisura aq sa mund të shihet lëkura që është farz të pastrohet, mes'hi nuk lejohet. Imam Shafiu e ka qëndrimin e tij të hershëm se mes'hi lejohet nëse me to ende mund të ecë dhe nuk është shumë e grisur. Kështu mendon edhe Imam Malikiu. Për shkak të nevojës së madhe, dhe pamundësisë për t'i riparuar rregullisht mestet gjatë udhëtimit, kjo edhe mund të tolerohet.

Mes'i lejohet edhe mbi çorapa të thurura, të qepura shtrënguar, nëse mbulon këmbën dhe lëkura nuk mund të shihet. Mes'h bëhet edhe nëse çarja është sipër dhe e qepur, sepse në këtë detyron nevoja. Çfarëdo që të jenë mes'tet, ato duhet të mbulojnë deri përmbi zog të këmbës. Por, nëse mestet mbulojnë vetëm pjesën e poshtme, e pjesa e epërme të jetë e mbështjellur me ndonjë arrnë, nuk bëhet mes'h mbi te.

²⁸Sipas medh'hebeve Hanefi dhe Hanbeli, mes'hi mbi çorapat e leshta lejohet nëse janë çorapë të trasha dhe të shtrënguara mirë edhe nuk e lëshojnë ujin menjëherë. Por nuk është mënyrë tradicionale e vepimit.

4. Pasi të ketë bërë mes'h, mos t'i heqë mestet. Nëse i z bathë, më mirë le ta ripërtërijë abdesin (nëse nuk e ka prishë abdesin në një mënyrë tjetër) ani pse do t'i mjaftonte të pastronte vetëm këmbët.

5. Mes'h të bëjë në pjesën të cilën është farz të lahet. Mes'h nuk bëhet nga thembra e përpjetë. Më së paku që duhet të bëjë është mes'h mbi pjesën e jashtme të mestes (anën e sipërme). I mjafton nëse bën mes'h me vetëm tre gishta. Megjithatë, më mirë e ka të evitojë çfarëdo dyshimi, për shkak të dallimeve mes fakihëve, mes'hi më i plotë do të ishte kur bëhët edhe në anën e sipërme edhe në anën e poshtme të mestes, një herë, pa përsëritje. Kështu ka vepruar Resulallahu s.a.v.s.

Duart të jenë të lagura, duke i vendosur majat e gishtërinjve të dorës së djathtë në majat e gishtërinjve të këmbës së djathtë, dhe bën mes'h me tërheqje të gishtërinjëve dorës kah vetja. Pastaj do të vendos majat e gishtërinjve të dorës nën meste dhe duke filluar nga thembra i tërhjekë kah gishtërinjtë e këmbës.²⁹

Nëse bën mes'h deri sa është akoma në shtëpi dhe niset për rrugë, ose bën mes'h sa është në udhëtim e pastaj mbërrin në shtëpi, atëherë përparësi i jepet

²⁹Edhe sipas medh'hebit Hanefi është njejtë, por nën meste (pjesa e shputës) mes'h nuk bëhet.

rregullit për qëndrim në shtëpi, pra mes'hi do të llogaritet në një ditë e një natë (pra, 24 orë).³⁰

Koha prej tri ditësh do të llogaritet nga momenti kur priset abdesi, pasi që veç ka bërë mes'h përmbi meste. Nëse mestet i ka mbathur si mysafir dhe mes'h gjithashtu bën deri sa është mysafir, e pas kësaj niset për udhëtim dhe i priset abdesi, për shembull në mesditë, mes'hi do t'i vlejë tri ditë e tri netë, pra nga ajo mesditë deri në mesditën e ditës së katërt.

Kur dielli të fillojë të lajmërohet në ditën e katërt, mund të falet vetëm pasi t'i ketë larë këmbët. Le t'i lajë këmbët dhe le t'i mbathë mestet, e pastaj të ketë kujdes për kohën kur e prishë abdesin, dhe t'i llogarisë të gjitha nga fillimi, si më parë.

Nëse ende është në shtëpi dhe abdesi i priset pasi të ketë mbathur mestet, dhe niset në udhëtim duke bërë mes'h mbi mestet, prapë mund ta bëjë mes'h mbi meste tri ditë e tri netë. Kjo është kështu sepse mestet zakonisht edhe mbathen pak para nisjes për rrugë, ndërsa kujdesi për të mos prishur abdesin nuk është edhe aq i lehtë. Por, nëse ka bërë mes'h mbi meste si mysafir, atëherë është si ata që qëndrojnë në shtëpi.³¹

³⁰Sipas medh'hebit Hanefi, nëse bën mes'h deri sa është akoma në shtëpi dhe niset për rrugë, mes'hi do t'i vlejë tri ditë e tri netë. Nëse qëndron në një vend si mysafir, llogaritet një ditë e një natë (24 orë).

³¹Sipas medh'hebit Hanefi, mes'h mbi mestet fillon të llogaritet nga momenti kur priset abdesi, edhe për udhëtarin (mysafirin) edhe

Është sjellje e lavdërueshme (*mustehab*) për secilin që dëshiron të mbathë meste, qoftë ai udhëtar ose jo, që t'i shkundë mestet para se të mbathë. Transmetohet nga Ebu Umame:

“Resulallahu s.a.v.s., i kërkoi mestet e tij. Kur e mbathi njëren, në atë moment një korb ia rrëmbeu mestin dhe fluturoi e pastaje lëshoi në tokë dhe prej mestit doli një gjarpër. Prandaj Resulallahu s.a.v.s., tha:

“Kush beson në Allahun dhe në Ditën e Gjykimit, mos t'i mbathë mestet pa i shkundur.”³²

Lehtësimi i dytë

Lehtësimi i dytë është marrja tejemmum,³³ kur ka vështirësi në sigurim të ujit. E *vështirësi* do të ishte nëse, deri sa të sigurojë ujin, do t'i largohet karvani. Por udhëtarin nuk mund ta dijë gjithnjë se sa do të ishte kjo largësi. Pra, në këtë situatë merr tejemmum. Për shkak që uji është shumë larg, konsiderohet që nuk mund të gjejë ujë. Njëjtë konsiderohet që nuk ka ujë edhe nëse uji është afër, por i zaptuar nga armiku ose kafshët e egra.

për atë që qëndron në shtëpi (banorin). Nëse i prishet abdesi para se të dalë në udhëtim, kur niset në rrugë i plotëson tri ditë.

³² Shënon Taberani

³³ Tejemmum është pastrim me dhé kur nuk ka ujë, kur myslimani duhet të marrë abdes ose duhet të lahet, e nuk ka ujë, dhe ka vështirësi në sigurim të ujit, ose s'guxon të përdorë ujin, atëherë, në vend të abdestit ose guslit me ujë, merr tejemmum me dhé.

Tejemmum lejohet edhe nëse uji që e ka i duhet për pije, atë ditë ose të nesërmen. Njëjtë edhe kur ai ujë i nevojitet bashkudhëtarit për të shuar etjen; abdesi me atë ujë nuk i lejohet, por është i obliguar ta japë, qoftë me pagesë ose falas.

Nëse ka ujë pak dhe dëshiron ta përdorë për të përgatitur gjellë, mish ose çorbë, atëherë nuk i lejohet *tejemmum*, por duhet të marrë abdes dhe të mjaftohet me bukë të thatë. Sepse përgatitja e gjellës, mishit ose çorbës nuk është e domosdoshme.

Sa herë që i dhurohet ujë udhëtarit, ky duhet ta pranojë. Nëse dikush i ofron para në vlerë të ujit, ato nuk ka nevojë t'i pranojë sepse mund të dalin fjalë. Ujin që shitet me çmim të arsyeshëm, nëse ka para, duhet ta blejë. E nëse çmimi është shumë i lartë, nuk obligohet që ta blejë për abdes. Nëse udhëtari nuk ka ujë me vete, së pari duhet të kërkojë ujë përreth, për shembull në mesin e torbave dhe enëve, dhe të pyes udhëtarët karvanit. Nëse nuk gjenë pas këtij kërkimi, bën *tejemmum*. Nëse ka bërë *tejemmum*, e pastaj është kujtuar se ka pasur ujë por e ka harruar në torbë, ose që ka një krua aty afër, i duhet të përtërijë namazin, sepse nuk është përpjekur mjaft. Nëse ka mundësi të gjejë ujë kah fundi i vaktit për namaz, më mirë e ka të fal namazin me *tejemmum* qysh në vaktin e parë, sepse

nuk është i sigurt se a do të jetojë deri atëherë, ndërsa kënaqësia e Allahut është në vaktin e parë.³⁴

Abdullah b. Omeri r.a., një herë morri tejemmum; ia panë për të madhe e i thanë:

- *Pse po merr tejemmum, kur iu afruam qytetit?, e Ibn Omeri r.a., ua ktheu:*

- *Ku mund ta di a do të hyj në qytet?!*

Nëse uji gjendet pasi që tashmë ka filluar të falet, namazi nuk i prishet, e as nuk do të obligohet të marrë abdes.³⁵ Por nëse ujin e gjen para se të fillojë namazin, i duhet të marrë abdes.

Kur nuk ka ujë, le të gjejë dhé të terur e të pastër le ta prekë dheun me shuplakë, me gishta të bashkuar, dhe të fërkojë fytyrën një herë. Pas kësaj, të prekë për herë të dytë në dhé, pasi të ketë hequr unazën, duke i hapur gishtërinjtë, dhe me dorën e majtë të fërkojë djathën deri mbi bërryl, e me të djathtën e fërkon të majtën deri mbi bërryl, një herë. Nëse me një goditje nuk merr aq dhé sa për të fërkuar të dy duart, do të godasë dhéun prapë. E kemi shpjeguar si bëhet kjo në *Librin e fshehtësive të pastrimit*, e të mos përsëritemi.³⁶

³⁴Sipas medh'hebit Hanefi, nëse ka mundësi të gjejë ujë, atëherë duhet të presë deri kah fundi i kohës së namazit.

³⁵Sipas medh'hebit Hanefi, nëse uji gjendet tejemmumi prishet; duhet të marrë abdes me ujë dhe ta fal namazin.

³⁶Sipas medh'hebit Hanefi, tejemmumi është i pranueshëm me dhé të terur e të pastër apo edhe me lloj dheu nga i cili çohet pluhur

Pasi që e falë një namaz farz, me tejemmum të njëjtë mund të falë edhe sa të dojë nafile. Por nuk mund të falë dy namaze farz me një tejemmum, për farzin e dytë i duhet të ripërtërijë tejemmumin.³⁷

Mos të marrë tejemmum pa filluar vakti i namazit, përndryshe do t'i duhet t'a përsërisë kur të fillojë vakti. Kur e fërkon fytyrën, duhet ta bëjë nijet që po merr tejemmum për të falë namazin. Nëse gjen vetëm pak ujë, aq sa do të mjaftonte për vetëm një pjesë të abdesit, do të përdorë aq sa ka ujë, e pastaj bën tejemmum.³⁸

Lehtësimi i tretë

Shkurtimi i namazit farz. Udhëtari (*mysafiri*) do t'i shkurtojë farzin e drekës, ikindisë dhe jacisë, por me tri kushte:

1. Namazet t'i falë në vaktin e tyre. Nëse kalon koha e namazit (kaza), atëherë më e drejtë është t'i falë të plotë - katër reqate.
2. Të bëj nijet për namaz të shkurtuar. Nëse bën nijet namazin e plotë, atëherë kjo i bëhet obligim. Nëse

³⁷Sipas medh'hebit Hanefi, tejemmumi e zëvendëson abdesin. Çdo ibedet që bëhet me abdes, bëhet edhe me tejemmum. Pra deri të prishet tejemmumi falë namazet e farzit dhe sa të dojë nafile, është sikur të jetë me abdes.

³⁸Sipas medh'hebit Hanefi, nëse nuk ka mjaftueshëm ujë për të marrë abdes, llogaritet se nuk ka ujë, dhe është e panevojshme larja vetëm e duarve ose këmbëve me këtë ujë.

nuk është i sigurtë se a e ka bërë nijet për namaz të plotë apo të shkurtuar, i duhet të falë namaz të plotë; dhe

3. Mos të falet bashkë me atë që nuk është udhëtar ose me udhëtarin i cili po falë namaz të plotë. Në atë rast edhe këtij i duhet të falë namaz të plotë. Edhe nëse dyshon se a është imami udhëtar apo jo, do të falë namaz të plotë. Nëse megjithatë e kupton se imami është udhëtar, sepse shenjat e udhëtarit janë të dukshme, le ta bëj nijetin përshtatshëm kësaj, edhe nëse nuk e ka të qartë se a e ka bërë ai imam nijet për namaz të shkurtuar apo jo, dhe kjo nuk e dëmton, sepse nijeti i tjetrit nuk mund të dihet. E krejt kjo vlenë, nëse udhëtimi është i gjatë dhe i lejuar (mubah).³⁹

Në përcaktimin e largësisë së udhëtimit, prej fillimit të tij deri në fund, ka vështirësi. Prandaj këtë çështje duhet njohur mirë:

Udhëtim është largimi nga vendi i qëndrimit, me nijet të qartë, në destinacion të caktuar. I hutuari, ai që sorollatet pa qëllim, nuk mund të përdorë lehtësimet. I tillë është secili që nuk ka destinacion të caktuar ku është nisur, e as nuk do të jetë udhëtar ai që nuk largohet nga vendi ku jeton. Nuk llogaritet mysafir deri

³⁹Sipas medh'hebit Hanefi, udhëtari (mysafiri) i cili shkon në largësi prej 18 orësh, nëse nuk i përshtatet imamit i cili falë namazin e plotë, për namazet me katër reقاتet farz është i detyruar t'i falë dy reqate. Bile nëse një namaz katër reqate farz nuk e falë në kohë, edhe kaza e falë dy reqate.

sa nuk largohet jashtë periferisë së qytetit. Por nuk është kusht të largohet edhe nga vreshta ku banorët dalin verës. Sa për fshatin, udhëtari duhet të kalojë arat e punuara, por jo edhe fushat e djerra.⁴⁰

Nëse udhëtari kthehet në qytet të vet për të marrë diçka që ka harruar, nuk do të mund të përdorë lehtësimet aty, deri sa prapë nuk largohet. Lehtësimet mund t'i përdorë nëse nuk është qyteti i vet, sepse ai është bërë mysafir (udhëtar).

E fundi i udhëtimit lidhet me tri çështje:

1. Arritja në vendin ku dëshiron të vendoset;
2. Nijeti për të qëndruar tri ditë ose më gjatë, qoftë në qytet apo në shkretëtirë;⁴¹ dhe
3. Çështjet e ditës së qëndrimit. Për shembull, nëse vendoset në një vend dhe aty qëndron tri ditë pos ditës së arritjes, pas kësaj nuk do të ketë lehtësi.

Nëse nuk e ka nijet të qëndrojë, por ka ndonjë punë dhe secilën ditë pret se do të kryhet, por puna i zgjatet, atëherë mund të vazhdojë t'i përdorë lehtësimet, edhe pas tri ditësh. Kjo, sipas mendimit dominues, për shkak që i tilli është i shqetësuar; është larg shtëpisë. Nëse në shikim të parë duket sikur udhëtari është vendosur diku, kjo nuk do të thotë që ai nuk është i shqetësuar.

⁴⁰Sipas medh'hebit Hanefi, duhet të kalojë kufirin e qytetit ose fshatit.

⁴¹Sipas medh'hebit Hanefi, nijeti për të qëndruar duhet të jetë 15 ditë në atë vend ku shkon, edhe nëse qëndron 14 ditë, duhet të falë namazet si mysafir, pra t'i shkurttojë.

Gjithashtu, nuk ka rëndësi nëse në udhëtim është për të luftuar apo për diçka tjetër, si edhe nëse koha do të shkurtohet apo zgjatet, ose nëse do t'i duhet të shtyejë largimin për shkak të shiut për të cilin nuk e di se a do të ndalet për tri ditë, ose për diçka tjetër. Në një nga udhëtimet e tij, Resulallahu s.a.v.s., në vendin ku ishin vendosur, i shkurtoi namazet për tetëmbëdhjetë ditë.⁴²

Kaq për shkurtime të namazit.

Sa për gjatësinë e rrugës, mendohet mes dy konakëve (*merhale* - një ditë rrugë). Secili konak përbëhet nga tetë *fersahë*. Secili *fersah* ka tri milje. Secila milje përbëhet nga katër mijë hapa, e secilin hap e përbëjnë tri shputë.

Udhëtim i lejuar nuk është ikja nga prindërit si padëgjueshmëri ndaj tyre, as ikja e skllavit nga pronari, as ikja e gruas nga burri, as ikja e borxhlisë nga borxhi - derisa borxhin mund t'a kthejë, as të niset për rrugë me qëllim të plaçkitjes së udhëtarëve, vrasjes, për të fituar haram ose për të mbjellë farën e ngatërresave mes myslimanëve.⁴³

⁴²Shënon Ebu Davudi në tregimin për çlirimin e Mekes. Edhe Buhariu transmeton hadith gati të njëjtë, nga Ibn Abbasi, por me qëndrim prej nëntëmbëdhjetë ditësh, deri sa Ebu Davudi përmend shtatëmbëdhjetë ditë, e në një transmetim tjetër bile pesëmbëdhjetë.

⁴³ Sipas medh'hebit Hanefi, personi që e bën nijet të shkojë 90 km largësi, ai është mysafir, e qëllimi i udhëtimit nuk kërkohet. Nëse

Shkurt, njeriu niset në rrugë me një qëllim. Ky qëllim shkakton lëvizjen.

Nëse përmbushja e atij qëllimi do të ishte diçka haram, namazin nuk mund ta shkurtojë.

Nëse ka dy qëllime, njëri i mirë e tjetri i keq, por nuk i përkulet të keqes dhe është i detyruar të udhëtojë në këtë gjendje, atëherë prapëi shkurton namazet.

Për udhëtimin e sufive që kanë qëllim vetëm të vizitojnë vendet e ndryshme, ka mospajtim a duhet të shkurtohen ose jo namazet, e lejen për shkurtimin e namazeve duhet t'a japë ai që e ka të drejtën të vendosë në mënyrë të pavarur.

Lehtësimi i katërt

Bashkimi i namazit të drekës dhe ikindisë në vaktet e tyre, si edhe të namazit të akshamit dhe të jacisë në vaktin e tyre. Kjo gjithashtu është e lejuar në secilin udhëtim që është arsyeshëm i gjatë dhe është udhëtim i lejuar. Ndërsa për udhëtimet e shkurta, mendimet ndahen.

Shembull: nëse namazin e ikindisë do ta falë në kohën e drekës, kjo ka tri kushte:

E para: duhet ta bëjë nijet për bashkimin e namazeve mes drekës dhe ikindisë, në kohën e drekës.

shkon me nijet të mirë, sevapi është për të, e nëse shkon me nijet të keq, kjo nuk ndikon në mysafillëkun e tij.

E dyta: duhet ta thërrasë ezanin për namaz të drekës, e pastaj edhe ikametin. Sapo të përfundojë me namaz të drekës, le të thërrasë ikametin për namazin e ikindisë, së pari duke ripërtërirë tejemmumin, nëse edhe farzin e drekës e ka falë me tejemmum. Në mes të farzeve të drekës dhe ikindisë le të ketë kohë aq sa për të ripërtërirë tejemmumin dhe për të thirrë ikamet. Nuk lejohet që së pari të falet ikindia. Nëse e bën nijet bashkimin e namazeve pasi që tashmë ka hyrë në vaktin e ikindisë, sipas Muzeniut, kjo lejohet. Diçka e tillë ka mbështetje edhe në analogji, sepse nuk ka bazë që të përcaktohet përparësia e nijetit.

Në fakt, sheriati ka lejuar bashkimin, e kjo është bashkim, ndërsa lehtësimi ka të bëjë me namazin e ikindisë. Prandaj nijeti për drekën mjafton edhe nëse bëhet në vakt të ikindisë.

E treta: sunnetet e namazit të drekës nuk falen menjëherë, por falen pas ikindisë, qoftë ulur ose në këmbë. Pra, nëse falen pas farzit të drekës, do të ndërpritej vazhdimësia, e kjo vazhdimësi, sipas një mendimi, është e domosdoshme. Nëse dëshiron të falë katër reqate sunnet që falen para farzit të drekës, si edhe katër reqate sunnet që falen para ikindisë, le ti bashkojë para se të fillojë faljen e dy farzeve. Fillimisht do t'i falë sunnetet e drekës, pastaj sunnetet e ikindisë,

pastaj farzin e drekës, më pas farzin e ikindisë, dhe në fund dy reقاتet e sunnetit të drekës të cilat përndryshe do t'i falte pas farzit të drekës.

Gjatë udhëtimit mos t'i braktisë namazet nafile. Sevapi që fitohet me to është më i madh se fitimi që sjellë udhëtimi, sidomos që sheriati lejon faljen e tyre edhe në mjet të udhëtimit. Nëse namazin e drekës e shtyen deri në ikindi, do t'i përmbahet renditjes së lartëcekur. Nuk ka problem që në fund dy reقاتet e sunnetit të drekës t'i falë pas ikindisë ose në kohë të papërshtatshme, sepse për udhëtarin nuk vlenë arsyeja që atë kohë e bën të papërshtatshme.

Njëjtë do të veprojë edhe me namazin e akshamit, namazin e jacisë dhe vitrin, nëse i bashkon e i falë në vakt të akshamit apo të jacisë. Të gjitha sunnetet do t'i falë pasi t'i ketë falur farzet, dhe tek pas kësaj falë vitrin.

Nëse i kujtohet namazi i drekës para se të kalojë vakti i tij, le ta bëjë nijet që ta falë bashkë me ikindinë. Kjo do të llogaritet sikur nijet për bashkim të namazeve, ani pse nuk ka menduar t'i bashkojë. Përndryshe, i mbetet vetëm ta lëshojë drekën pa falë, ose t'a falë pas ikindisë. E kjo është haram.

Nëse nuk i kujtohet namazi i drekës deri sa vakti i drekës të kalojë, qoftë për shkak të gjumit ose ndonjë pune, i takon ta falë bashkë me ikindinë. Nuk do të bëjë gjynah, sepse udhëtimi, pos që vështirëson faljen e namazit, gjithashtu vështirëson kujdesin për vaktet.

Mund të thuhet edhe se koha e faljes së namazit të drekës i bie në momentin e vendimit për ta falë, para se t'i kalojë vakti. Mirëpo, më e mundur duket të jetë që vakti i drekës dhe ikindisë në udhëtim bëhen një, i përbashkët, në mes të dy namazeve. Prandaj gruaja me menstruacione e ka obligim të falë namazin e drekës, nëse menstruacionet i ndalojnë në vaktin e ikindisë.

Nga kjo del që në mes të drekës dhe ikindisë nuk kushtëzohet radhitja, e as te shtyerja e drekës. Por kjo nuk lejohet nëse namazi i ikindisë bartet në kohën e drekës, sepse pas faljes së namazit të drekës mbetet koha e paraparë për ikindi. Pra, nuk ka logjikë të merret me ikindi ai që ka vendosur të braktisë ose të shtyejë namazin e drekës. Arsyetimi me shiun lejon bashkimin e namazeve, njëjtë siç lejon arsyetimi me udhëtimin.

Një nga lehtësimet në udhëtim është edhe që udhëtari nuk obligohet të falë namazin e xhumasë, e ajo gjithashtu lidhet me farz.

Nëse udhëtari pasi të ketë falur ikindinë si mysafir (dy reqate) vendos të qëndrojë, do t'i duhet ta falë ikindinë prapë, para se të dalë vakti i ikindisë. Sepse arsyet për të qenë namazi i rregullt vlejnë deri në kohën e akshamit.

Lehtësimi i pestë

Falja e namazeve nafile në mjetin e transportit. Resulallahu s.a.v.s., do të falej në secilin mjet udhëtimi, kahdo që udhëtonte. Në to e falte edhe namazin e vitrit.⁴⁴

Ai që nafilet i falë deri sa është në mjet të udhëtimit, për *ruku* dhe *sexhde* vetëm do të japë shenjë (lehtë të përkulet). Përkulja për *sexhde* le t'i jetë më e madhe se ajo për *ruku*. Nuk ka nevojë të përkulet aq sa do t'i jetë parahatshëm, për shkak të mjetit. Megjithatë, nëse fal nafile në ulëse, le t'i plotësojë edhe rukunë edhe *sexhden*, sepse është në gjendje ta bëjë këtë.

Sa për kthimin kah kibla, ky nuk është obligim, as në fillim të namazit as gjatë tij. Megjithatë, le të ketë kujdes për drejtimin e rrugës, në vend të kiblës. Në të gjitha namazet e tilla duhet të ketë kujdes, ose për kiblën ose për drejtimin e rrugës, në mënyrë që të ketë drejtim që do ta ndjekë. Nëse mjetin transportues e devijon qëllimisht nga rruga, namazi do t'i priset, pos

⁴⁴ Hadithi është muttefekun-alejhi, transmetuar nga Ibn Omeri r.a..

nëse e drejton mjetin kah kibla. Nëse e kthen në harresë, e kohë ka mbetur pak, namazi nuk i prishet. Por nëse mbetet kohë e mjaftueshme, këtu mendimet ndahen se si të veprohet. Nga ana tjetër, nëse kafsha është e padisiplinuar e vet kthehet, namazi nuk prishet, sepse kjo ndodh shpesh. Nuk i duhet as të bëjë sehvi-sexhden, sepse ai nuk ka nën kontrollë sjelljen e kafshës, ndërsa e kundërta është nëse harron. Në atë rast do të bëjë sehvi-sexhde, duke bërë shenjë (me përkulje të lehtë).

Lehtësimi i gjashtë

Lejohet falja e namazit nafie deri sa ecë gjatë udhëtimit. Ruku dhe sexhde do të bëjë me dhënie shenjë (përkulje të lehtë), deri sa për teshehud (ulje) nuk do të ulet, përndryshe prishtet dobia e lehtësimit.

Këmbësori do të veprojë njëjtë si kalorësi. Megjithatë, në namaz duhet hyrë i kthyer kah kibla. Këmbësori nuk e ka të vështirë të kthehet kah kibla, së paku për një moment, ndryshe prej kalorësit, i cili e ka vështirë që kafshën ta kthejë kah kibla, ani pse i mbanë frerët në dorë. E këmbësori mundet edhe të falë më shpesh namaz, e edhe t'i zgjasë ato.

Gjithashtu, të mos shkelë qëllimisht në papastërti të lagur. Nëse vepron kështu, i prishet namazi, por jo

nëse kafsha shkelë. Megjithatë, mos të lodhet shumë duke e ruajtur bash secilin hap nga papastërtitë të cilat rruga zakonisht i ka.

Dhe në fund, edhe farzin le t'a falë duke kalëruar ose ecur, nëse është në ikje nga armiku, vërshimet ose bishat, ashtu siç e kemi shpjeguar për namazet nafile.

Lehtësimi i shtatë

Prishja e agjërimit. Udhëtari do ta prishë agjërimin, por nëse për rrugë niset më vonë, atëherë agjërimin e asaj dite duhet kompletuar. Nëse e zë mëngjesi si udhëtar agjërues, e pas kësaj ndalet, duhet të kompletojë agjërimin. Nëse vendoset si jo-agjërues, nuk ka nevojë të përmbahet për pjesën e mbetur të ditës. Nëse e zë mëngjesi si udhëtar dhe tashmë e ka bërë nijet për të agjëruar, kjo nuk e obligon; nëse do, mund t'a ndërpresë agjërimin.

Të agjërohet është më mirë se sa të mos agjërohet, ndërsa të shkurtohet namazi është më mirë se sa të falet i plotë, në mënyrë që të largohet dyshimi dhe dallimet për atë çështje, si edhe për shkak që namazet që i ka shkurtuar nuk është i obliguar t'i falë përsëri, për dallim nga agjërimi i ndërprerë, të cilin duhet t'a kompenzojë më pas. Por, nëse agjërimi i paraqet problem, atëherë më mirë të mos agjërojë.

Pra, këto janë ato shtatë lehtësimet që udhëtari mund t'i përdorë:

Tri prej tyre lidhen me rrugë të gjatë, e që janë shkurtimi i namazit, mundësia për të mos agjëruar dhe zgjatja e mes'hit për tri ditë.

Dy prej tyre lidhen me udhëtimin, qoftë udhëtim i shkurtë apo i gjatë, e këto janë se nuk e ka obligim të falë xhumanë, si edhe që nuk është i obliguar të përsërisë namazin e falur me tejemmum.

Sa për namazet nafile, që falen edhe duke ecur edhe duke udhëtuar me mjet transporti, ka një ndarje të caktuar në mendimet e dijetarëve. Gjykimi më i drejtë është se kjo është e lejuar edhe në udhëtimet e shkurta. Dallim ka edhe për bashkim të namazeve, e më e pranueshme është se kjo lejohet në udhëtimet e gjata.

Sa për lehtësimin për falje të farzit në lëvizje për shkak të ndonjë frike, kjo edhe nuk lidhet me udhëtimin si të tillë. Rasti i këtillë është i njëjtë me konsumimin e kafshëve të mbytura, ose me faljen e namazit me tejemmum - kur nuk kemi ujë. Në këto raste vlejné kushtet e njëjta, si në shtëpi si në udhëtim, nëse lajmërohen parakushtet e kërkuara.

Nëse ti pyet: *'A e ka mysafiri obligim (vaxhib) t'i dijë këto lehtësime ende para udhëtimit, apo e ka vetëm lavdërueshme (mustehab)?'*, dije se:

Nëse dikush vendos paraprakisht se nuk do të përdorë mes'h, nuk do t'i shkurtojë e as t'i bashkojë namazet, nuk do ta ndërpresë agjërimin e as të falë nafilet në lëvizje - ky nuk e ka obligim t'i njohë kushtet që ia mundësojnë përdorimin e lehtësirave, sepse as përdorimin e tyre nuk e ka obligim. Megjithatë, njohjen e lehtësimit për tejemmum e ka të obliguar, sepse nuk varet prej tij se a do të mbetet pa ujë apo jo, pos nëse e di se gjithmonë do të udhëtojë skaj bregut të lumit, dhe është i sigurtë se lumi nuk do të shterret; ose edhe e ka gjithmonë bashkëudhëtar një dijetar islam, të cilit mund t'i drejtohet kur i duhet. Ai mund t'a vonojë mësimin e lehtësimeve deri sa nuk ka nevojë për to. Por, nëse e di se nganjëherë nuk do të ketë ujë, dhe se afër tij nuk do të gjendet gjithmonë një dijetar, atëherë po, e ka obligim t'i mësojë lehtësimet.

Mund të pyesësh: *'Tejemmum është i obliguar për namazin, vakti i të cilit ende nuk ka hyrë. Pse pra është e obliguar të njihen rregullat e pastrimit për namaz i cili ende nuk është bërë i obliguar, e ndoshta as nuk do të bëhet?'*, e të përgjigjemme një shembull të haxhit:

Siç është vaxhib të niset në rrugë për haxh disa muaj para se të hyjë muaji i haxhit, nëse mes tij dhe Mekes ka një distancë shumë të largët (me muaj), atëherë është vaxhib edhe të mësohen rregullat e haxhit, nëse mendon se rrugës nuk do të takojë dikë nga i cili do të mësojë, e qëllim e ka arritjen në kohë për haxh. Që të arrihet cilido vaxhib, gjithashtu është vaxhib të mësohet ajo që është e domosdoshme.

Nëse pritet se do të lajmërohet një obligim i caktuar, i cili nuk do të mund të kryhet pa ndonjë kusht paraprak, atëherë duhet paraprakisht njoftuar me atë kusht. Sikur rregullat e haxhit, të cilat mësohen para kohës së haxhit dhe para se haxhi të bëhet. Prandaj, mysafirit nuk i lejohet që të niset për rrugë para se të mësojë mjaftueshëm për tejemmum. Nëse vendos të përdorë edhe lehtësimet tjera, do t'i duhet t'i mësojë edhe gjërat tjera për të cilat folëm. Nëse nuk di aq sa i duhet për t'i përdorë lehtësimet, as nuk mund t'i përdorë ato.

Mund të pyesësh: *'Çka ka dert nëse udhëtari nuk e di si falet namaz nafile në lëvizje? Më e keqja që mund t'i ndodhë është se nuk do t'i pranohet ai namaz, e edhe ashtu nuk e ka obligim. Pse pra ta ketë obligim njohjen e lehtësimeve lidhur me të?', e përgjigja është kjo:*

Nafile namazi nuk është *vaxhib* (obligim). Por nëse e falë, është *vaxhib* të mos e falë namazin nafile në mënyrë të keqe e të gabuar. Të falet namazi nafile pa abdes, me ndonjë papastërti, duke mos qenë i kthyer kah kibla, pa përmbushjen e *sharteve* (kushteve) dhe *rukneve* (pjesëve përbërëse) të namazit – është haram.

Prandaj e ka obligim të mësojë atë me çka namazi nafile nuk i *refuzohet*, duke u ruajtur të mos futet në atë që është e ndaluar.

Pra, këto ishin lehtësimet të cilat udhëtari mund t'i përdorë gjatë udhëtimit.

Pjesa e dytë

OBLIGIMET QË LAJMËROHEN NË UDHËTIM

Bëhet fjalë për gjetjen e drejtimit të kiblës dhe të vakteve të namazit, e që është *vaxhib* edhe në shtëpi dhe që secili mysliman i devotshëm duhet t'jidijë.

Megjithatë, në shtëpi njeriu mund të orientohet sipas *mihrabit* (xhamisë), prandaj nuk ka nevojë të kërkojë drejtimin e kiblës, ndërsa sipas muezinit mund të orientohet për vaktet e namazit, që e çliron nga nevoja për të njohur përcaktimin e tyre.

Por, për udhëtarin nganjëherë nuk është e lehtë të caktojë drejtimin e kiblës, e as vaktet e namazit. Prandaj e ka obligim të njohë treguesit që do ta orientojnë kah kibla dhe për vaktet e namazit.

Sa për treguesit, shenjat e kiblës, ato mund të ndahen në tri grupe: *tokësore*: siç është orientimi me ndihmën e maleve, vendbanimeve apo lumenjëve; *ajrore*: siç është orientimi me ndihmën e erërave: veriore, jugore, lindore apo perëndimore; si edhe *qiellore*, e këto janë yjet dhe shtrirja e tyre.

Shenjat tokësore dhe ajrore dallojnë nga një rajon te tjetri. Sa e sa ka rrugë, që kanë ndonjë mal, që mund të jetë në të djathtë apo në të majtë të kiblës, para ose prapa saj. Këto gjëra udhëtari duhet t'i dijë! Njëjtë me erërat. Në disa vende ato janë tregues i mirë, prandaj le t'i njohë edhe ato. Megjithatë, nuk e kemi për qëllim që të hulumtojmë detajisht gjithçka, sepse secili vend dhe secila klimë i ka treguesit e vet specifik.

Shenjat në qiell mund të ndahen në të ditës dhe të natës. Ditor është, për shembull dielli. Para se të niset nga një vend, udhëtari duhet të shikojë se ku është dielli në raport me të në mesditë, a e ka mes vetullave, në sy të djathtë, në të majtin, apo më afër zverkut. Në vendet më veriore, matjet ndryshojnë. Kur këtë të mbajë në

mend dhe të kuptojë pozitën e diellit në mesditë sipas treguesit, do të dijë të përcaktojë drejtimin e kiblës.

Njëjtë do të vështrojë pozitën e diellit në vaktin e ikindisë.

Në këto dy vakte (drekë dhe ikindi), drejtimi i kiblës i duhet domosdo. E edhe kjo dallon nga vendi në vend. Nuk është e mundur të dihet saktësisht.

Në vaktin e akshamit, drejtimi i kiblës mund të caktohet sipas drejtimit kah perëndon dielli. Pra, do të mbajë në mend se a po perëndon dielli djathtë nga drejtimi i kiblës, apo përkulet drejt fytyrës ose zverkut.

Me të kuqërremtën e mbrëmjes në qiell mund të caktohet drejtimi i kiblës për namazin e jaxisë, deri sa me lindjen e diellit e cakton kiblën për namazin e sabahut.

Siç po shihet, me ndihmën e diellit mund të përcaktohet drejtimi i kiblës për të pesë vaktet e namazit, ani pse lajmërohen diferenca, varësisht se a është dimër apo verë. Ka shumë pika ku dielli lind dhe perëndon. Ani pse dy aso pika ndodhen në të dy anët, megjithatë duhet të përcaktohet se cili është drejtimi i kiblës.

Por, nganjëherë akshami dhe jacia falen pasi që të jetë humbur e kuqërremta nga qielli. Atëherë orientimi me ndihmën e diellit nuk ndihmon. Atëherë do të shikohet pozita e yllit polar (*kutb*).

Ky është ylli që e quajnë edhe *Bricjapi*. Ai është një yll statik, lëvizja e të cilit nuk mund të vërehet. Ai mund të jetë ose në të kundërtën e drejtimit të kiblës, ose në anën e majtë, ose në të djathtë. Kjo vlenë për vendet që janë në veri të Mekes. Në vendet jugore, siç është Jemeni dhe rajonet përreth, atje ky yll është në drejtim të kiblës. Udhëtari duhet t'i dijë këto gjëra!

Çka ka mësuar në vendin e vet, le ta aplikojë edhe në rrugë, pos nëse rruga zgjatet. Sepse kur largësia të rritet ndërron edhe pozita e diellit, pozita e yllit polar, pozita e pikave në të cilat dielli lind e perëndon.


Në këto nuk ka nevojë të ketë kujdes nëse udhëton nga një vend në tjetrin. Në atë rast do të duhej t'ju drejtohet njerëzve që i dinë këto çështje, ose të përcjellë pozitën e yjeve deri sa është i kthyer kah mihrabi në xhaminë lokale, që t'i qartësohet. Kush njoftohet me këto shenja, me to edhe do të shërbehet.

Nëse e kupton se ka gabuar në përcaktimin e drejtimit të kiblës, pra që nga katër anët ka zgjedhur anën e gabuar, do t'i duhet të ripërtërijë namazin. Nëse e ka gabuar drejtimin e kiblës, por jo edhe anën se kah është ajo, nuk do t'i duhet të falë namazin përsëri.

Fakihët japin mendime të ndryshme lidhur me atë se a kërkohet ana e kiblës (*xhihe*) apo drejtimi i saktë i kiblës (*ajn*). Kjo fillon të ju shkaktojë problem njerëzve. Nëse kërkohet drejtimi i saktë i kiblës, si është kjo e

mundur në vende të largëta? Nga ana tjetër, nëse mjafton ana, atëherë padyshim që nuk është i drejtë as namazi i atij që falet brenda në xhami, me fytyrë të kthyer kah kibla, por që me trup nuk është i drejtuar kah Qabeja. Diskutimi për dallimin në mes të anës dhe drejtimit të saktë tashmë është zgjatur.

Mbi të gjitha, duhet të kuptohet çka është *drejtimi i saktë* e çka *ana*. Drejtimi i saktë është që, kur njeriu të qëndrojë i kthyer kah kibla, prej pikës mes dy syve të tij e deri te muri i Qabes mund të tërheqë një vijë të drejtë, me çka në të dy anët krijohen kënde të barabarta. Ja edhe skica:




Atiji që falë jashtë *musallës* (xhamisë etj), mund të ndodhë që kjo vijë të mos i jetë bash drejt kah Qabeja. E kah ana, mund të ketë devijim të vogël, dhe dy këndet nuk do të jenë të njëjta në relacion me vijën drejt

Qabes. Ato kënde nuk janë baras deri sa vija nuk takohet me një pikë të caktuar. Nëse kjo vijë lëvizë majtas apo djathtas, një prej këndeve ngushtohet dhe largohet prej drejtimit të saktë, por jo edhe prej anës kah gjendet Qabeja. Kjo mund të shihet në skicën lartë.

Nëse namazliu qëndron në atë vijë drejt Qabes, ai do të jetë i kthyer kah ana e Qabes, por jo edhe kah vet Qabeja. Kufijtë e asaj ane gjenden në mes të dy vijave të cilat namazliu i paramendon, djathtas dhe majtas hapësirës së vet të shikimit.

Gjithçka mes atyre dy vijave llogaritet si ana e Qabes. Sa më të gjata vijat dhe sa më e madhe largësia prej Qabes, edhe hapësira mes tyre është më e madhe. Ja edhe skica e kësaj:



Kur të kuptohen mirë drejtimi i saktë dhe ana e Qabes, do të them se, sipas nesh, e drejtë është, bazuar në fetva, që nëse Qabeja mund të shihet, duhet pasur kujdes në drejtimin e saktë. Por nëse drejtimi duhet përcaktuar, për shkak që Qabeja nuk mund të shihet drejtpëdrejtë, në atë rast mjafton vetëm ana. Sa për drejtimin e saktë kur Qabeja shihet, aty të gjithë pajtohen. Nga ana tjetër, për mjaftueshmërinë dëshmi është Kur'ani, sunneti, veprimet e as'habëve dhe analogjitë.

Në Kur'an, Allahu Teala thotë:

“Kudo që të ndodheni, ktheni fytyrat tuaja nga ajo anë.” 2-Bekare: 150

Për atë që kthehet kah ana e Qabes edhe thuhet se fytyrën e ka kthyer kah drejtimi i Qabes. Sa për sunnetin, transmetohet nga Resulallahu s.a.v.s., që banorëve të Medines u ka thënë:

Kibla është në mes të perëndimit dhe lindjes.⁴⁵

Perëndimi është djathtas prej Medines, ndërsa lindja në anën e saj të majtë. Gjithçka mes tyre, Resulallahu s.a.v.s., e ka llogaritur se është kibla. Hapësira e Qabes sigurisht se nuk e mbulon gjithë

⁴⁵Shënon Tirmidhiu dhe e konsideron hadith sahih, si edhe Nesai, që e konsideron *munker*. Shënon edhe Ibn Maxhe nga Ebu Hurejre r.a.

hapësirën mes lindjes e perëndimit, por anën po. Ngjashëm transmetohet edhe nga hazreti Omeri r.a., dhe djali i tij r.a.

E sa për veprimet e as'habëve; transmetohet se xhemati në Kuba, ishin duke falur namazin me fytyrë të kthyer kah Mesxhidi Aksa, dhe erdhi njëri e i lajmroi që tash Qabeja ishte kibla, dhe ata (menjëherë) u kthyen kah Qabeja deri sa ishin në namaz, pa kërkuar asnjë tregues të drejtimit. Askush nuk ua kundërshtoi këtë veprim. Vet mesxhidi është quajtur *Xhamia me dy kibla*. Drejtimi i saktë i kibles nga Medina mund të caktohet vetëm me llogaritje të shumta matematikore. E si e gjetën ata sipas intuitës, gjatë namazit, në terrin e natës?

Nga praktika e as'habëve merret gjithashtu fakti se kanë ndërtuar numër të madh të mesxhideve rreth Mekes dhe në vendet e tjera, pa ftuar ndonjë ekspert për të caktuar drejtimin e mihrabit, ndërsa drejtimi i saktë mund të caktohet vetëm me llogari precize inxhinierike.

Sa për analogjinë, kthimi kah kibla është i domosdoshëm, si edhe ndërtimi i xhamijave në të gjithë botën, ndërsa drejtimi i saktë mund të përcaktohet vetëm me llogaritje profesionale, për të cilat sheriatu nuk thotë asgjë. Bile, ndoshta edhe ka ndaluar nga

thellimi (i tepërt) në to. Prandaj, për të plotësuar kushtin e drejtimit, mjafton t'i mbahemi anës kah është Qabeja.

Sa për precizitetin e skicës që kemi paraqitur, në të janë të përmbledhura të katër anët e botës. Resulallahu s.a.v.s., për edebin e kryerjes së nevojës (trupore) thotë:

“Deri sa kryeni nevojën, mos u ktheni kah kibla, as me gjoks e as me shpinë, por kthehuni kah lindja ose perëndimi.”⁴⁶

Këtë e ka thënë në Medine. Në atë rast lindja është majtas atij që është kthyer kah kibla, ndërsa perëndimi djathtas. I ka ndaluar dy anë, e dy tjerat i ka bërë të lejuara. Gjithsejt janë katër. Askujt nuk i shkon mendja se anë të botës mund të jenë gjashtë, shtatë, dhjetë etj. Çfarë do të ndodhte atëherë, edhe me çështjet tjera?

Ato anë janë caktuar duke u bazuar në konstruktin e njeriut i cili i ka katër anë: para, prapa, djathtas, majtas. Kështu, përshtatshëm pamjes së jashtme, për njeriun ka katër anë. Ndërsa sheriatit mbështetet vetëm në këso argumente. Nga e gjithë kjo del se ajo çfarë po kërkohet është pikërisht ana. Kjo e lehtëson edhe principin e *ixhtihadit* në këtë çështje, përmes së cilit edhe është e mundur të mësohen shenjat e kiblës.

⁴⁶ Muttefekun alejhi nga Ebu Ejjubi.

Nëse ti pyet: *'A do të ishte udhëtari gjynahqar nëse niset në rrugë pa njohjen e këtyre çështjeve?'*

Përgjigja ime është se nëse e ka rrugën në mes të vendbanimeve ku ka mihrabë (mesxhide etj), ose me të në rrugë është dikush që di të përcaktojë kah është kibla, në nderin dhe diturinë e të cilit mund të besojë, dhe të cilit mund t'i shkojë pas, në atë rast nuk do të ishte gjynahqar. Por, do të jetë gjynahqar nëse nuk ka asgjë nga këto, sepse ai është i obliguar të drejtohet kah kibla kur fal namazet, prandaj edhe këto duhet t'i mësojë, si çështet për tejemmum.

Nëse i ka mësuar këto dituri, por për shkak të kohës së vranët nuk mund të orientohet, ose edhe nuk i ka mësuar dhe rrugës nuk ka takuar dikë në të cilin do të mund të mbështetej, atëherë namazin e falë sipas mendimit. Por do t'i duhet të ripërtërijë namazin, pa marrë parasyshë a ia ka qëlluar drejtimit të kiblës apo jo.

Të verbrit do t'i duhet të mbështetet në tjetrin. Prandaj le të mbështetet në atë të cilit i beson për fe dhe mendjemprehtësi, nëse ai në të cilin mbështetet është muxhtehid në çështjen e kiblës. E nëse kibla do të ishte e dukshme, atëherë mund të mbështetet në fjalën e secilit të ndershëm, qoftë në rrugë apo në shtëpi.

Tutje, as i verbri e as i padijshmi nuk do të duhej të udhëtonin me karvanin ku nuk ka dikë që i njih shenjat e kiblës aq sa për të përcaktuar anën, njëjtë siç i padituri

nuk do të duhej të banojë në një qytet ku nuk ka dijetar për çështje të fesë. Në fakt ky do të duhej të bëjë *hixhret* (shpërngulje) në një vend ku mund të gjejë dikë që do t'ia mësojë fenë.

Njëjtë është edhe me qytetin ku ka vetëm dijetarë gjynahqarë. Përsëri i duhet të bëjë *hixhret*, sepse nuk mund të bazohet në fetvatë (vendimet juridike) të gjynahqarëve. Kusht për pranimin e fetvasë së dikujt është ndershmëria e tij, siç tregojnë transmetimet. Nëse një i tillë është i njohur për diturinë e tij, por nuk i dihet gjendja në lidhje me nderin dhe gjynahet, prapë do të pranohet mendimin e tij, deri sa të gjejë dikë me nder të dëshmuar.

E në rrugë, udhëtari nuk është bash në gjendje të hulumtojë ndershmërinë e myftiut. Nëse e sheh që ka veshur mëndafsh, ose që mëndafshi i dominon në rroba, ose që po kalëron kalin me shalë mbuluar me ar, do t'i ishte e qartë se ai është gjynahqar dhe fjalët e tij nuk do të duhej të pranohen. Le të kërkojë tjetër! Njëjtë do të ishte nëse e sheh duke ngrënë në sofrën e pushtetarit, pasuria e të cilit është haram, ose merr diçka me shumicë nga ai, qoftë edhe si dhuratë, e që nuk e di se a është hallall. Krejt këto janë gjynahe që shkatërrojnë drejtësinë, prandaj pengojnë pranimin e fetvasë, transmetimit ose dëshmisë nga të tillë.

Udhëtari duhet t'i njohë edhe pesë kohët të namazit. Vakti i drekës fillon nga momenti i kalimit të diellit nëpër zenit. Secilit njeri, në fillim të ditës hija e vet do t'i zgjatet kah perëndimi.

Pastaj do t'i shkurtohet deri te dreka, dhe pastaj hija përsëri fillon të zgjatet, por tash kah lindja. Kjo zgjatje e hijes vazhdon deri në perëndimin e diellit. Udhëtari le të ndalet në një vend ose le të ngulë në tokë një shkop të drejtë. Pas një kohe le të shikojë përsëri, dhe nëse e sheh që hija është zvogëluar, kjo do të thotë që koha e drekës ende nuk ka hyrë.

Mënyra se si do ta dijë këtë është se, kur muezini i besueshëm i një vendbanimi të madh këndon ezanin, ky le të shikojë gjatësinë e hijes së vet. Nëse hija është për shembull, tri shputë të tij, atëherë, gjithmonë kur është në rrugë e hija t'i mbërrijë atë gjatësi, ose pak më të madhe, do të falë namazin e drekës. Nëse hija i është zgjatur për gjashtë shputë e gjysmë, kjo do të thotë se ka hyrë vakti i namazit të ikindisë, dhe hija e secilit njeri do të jetë përafërsisht gjashtë shputë e gjysmë të tij.

Gjithashtu, hija e pasdites çdo ditë do të jetë më e gjatë, nëse në rrugë është nisur në fillim të verës. Nëse niset në fillim të dimrit, për çdo ditë, hija i shkurtohet.

Hija e pasdites më së miri do të njihet me veglën që shërben për këtë punë (*mizan*⁴⁷). Prandaj udhëtari le ta ketë me vete, dhe me ndihmën e saj le të mësojë për ndryshimet në hije për secilin vakt.

Sa për vaktin e akshamit, ai fillon me perëndimin e diellit. Megjithatë, perëndimin nganjëherë e fshehin malet, dhe atëherë duhet shikuar në drejtim të lindjes. Kur lajmërohet errësira në horizontin më të lartë, sa trashësia e një litari, koha e akshamit ka filluar.

Sa për jacinë, ajo shihet me zhdukjen e të kuqrremtës në qiell. Nëse pengojnë kodrat, do të dihet me lajmërimin e yjeve në qiell, dhe me shumësinë e tyre. Kjo mund të ndodh vetëm pas zhdukjes së të kuqrremtës së akshamit.

Sa për sabahun, koha e tij kalon ngadalë me agim, por për të mund të gjykohet drejtë vetëm pas kalimit të një kohe të caktuar. Më pas sabahu njihet me bardhësinë e zgjatur, të cilën syri i njeriut lehtë mund ta shohë. Kjo është koha e parë.

⁴⁷ Gazaliu përdor termin *el-mizan*, që përkthehet si 'peshore', por sigurisht që fjala është për ndonjë vegël tjetër që është përdorur për qëllimin e përmendur.

Resulallahu s.a.v.s., duke i mbyllë shuplakat, tha:

“Sabahu nuk është kështu, por është kështu kur hyjn bardhësia në këtë mënyrë (vendosi njërin gisht tregues në tjetrin, dhe i hapi)”⁴⁸.

Sabahu mund të caktohet edhe me ndihmën e 28 *vendndalimeve të hënës*, por kjo është e përafërt, jo plotësisht e saktë.

Mund të mbështetet vetëm në të pamurit e bardhësisë që zgjerohet. Disa mendojnë se sabahu lajmërohet para lajmërimit të diellit në katër vendndalime. Diçka e tillë është gabim, sepse ky është agimi i rrejshëm, dhe, siç tregojnë ata që marrin vesh nga këto punë, ai lajmërohet para diellit në dy vendndalime.

Krejt kjo është vetëm përafërsisht. Në këtë nuk bën të mbështetemi. Disa vendndalime lajmërohen të zgjatura, anash, e kështu shkurtohet koha e lajmërimit të tyre. E gjithë kjo ndryshon aq shumë nga vendi në vend, sa të flitet për këtë do të zgjatej tepër.

Shkurtimisht: nëse katër stacione deri te lajmërimi i tehut të diellit zgjasin sa një stacion, kur mbeten katër vendndalime para lajmërimit të diellit le të jetë i sigurtë se bëhet fjalë për agim të rremë. Kur mbeten dy

⁴⁸Shënon Ibn Maxhe nga Ibn Mesud, me transmetues sahih, por pa përmendur shuplakat dhe gishtat tregues. Hadith të njëjtë shënon edhe Ahmedi, me zingjir hasen.

stacione afër, le të jetë i sigurtë se po lind mëngjesi i vërtetë. E në mes të dy sabaheve mbetet përafërsisht aq sa janë dy të tretat e një stacioni, për të cilat ekziston dyshimi se a i takojnë mëngjesit të rremë apo atij të vërtetë, e kjo është fillimi i lajmërimit të bardhësisë dhe zgjerimi i saj para se të fillojë të shpërndalet në gjerësi.

Që nga momenti i dyshimit, agjëruesi duhet të përfundojë syfyryn, e namazliu të përfundojë vitrin. Sabahun nuk do ta falë deri sa të kalojë ajo periudhë e dyshimtë. Kur të jetë i sigurtë, atëherë do të falet.

Nëse dikush dëshiron të përcaktojë saktë kohën deri kur mund të hajë e të pi, e pas kësaj menjëherë të falë namazin e sabahun, nuk do të mundet. Për shkak të dyshimit dhe pasigurisë, nevojitet një pauzë. Mund të mbështetemi vetëm në atë që shohim, e nuk ka mbështetje në atë që shohim pa e parë dritën si zgjerohet në hapësirë, deri sa të lajmërohen fillimet e të verdhës.

Shumë njerëz kanë gabuar me këtë, duke u falur para se të fillojë vakti. Këtë e tregon edhe transmetimi nga Ebu Isa Tirmidhiu në veprën e tij *Xhami*, me një varg transmetuesish, nga Talk Ibn Ali, ku Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Hani e pini, e mos t’ju mashtrojë shndërritja e parë. Hani e pini deri sa nuk e shihni të kuqremtën.”⁴⁹

⁴⁹ Shënon Ebu Isa Tirmidhiu në veprën e tij *Xhami*, dhe thotë se është hadith *hasen-garib*. Shënon edhe Ebu Davud.

Kjo është e qartë, pra, që duhet të pritët e kuqremta.

Ebu Isa, në kapitullin e njëjtë këtë e tregon nga Adijj ibn Hatim, Ebu Dherr dhe Semur ibn Xhundub, e hadithi është hasen-garib, sipas së cilës dijetarët edhe mund të veprojnë.

Ibn Abbas r.a., ka thënë: *“Hani e pini deri sa të shkëlqejë drita”*, e autori i *el-Garibejn* thotë: *“...drita të shtrihet.”* Prandaj, nuk duhet orientuar me lajmërimin e dritës së verdhë e cila sikur lajmëron të kuqen.

Mysafiri (udhëtari) duhet të njohë vaktet, sepse nganjëherë do të ngutet me namaz para nisjes (për rrugë) që të kursehet nga zbritja prej mjetit të udhëtimit për namaz, e nganjëherë para gjumit, që të mund të pushojë. Nëse mësohet me shtyerje të namazit deri atëherë kur është i sigurtë, mund t’i tolerohet lëshimi i vlerës së vaktit të parë për namaz. Vet do të bartë mundin e faljes dhe shtyerjes së namazit, dhe kështu nuk do t’i mësojë vaktet e namazit. Problemi është me vaktet e para, jo me ato në mes.

Libri i edebit të udhëtimit përfundoi.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	3
RREGULLAT E SJELLES NË UDHËTIM	7
DOBITË, VLERA E LARTË DHE NIJETI I UDHËTIMIT	11
RREGULLAT E SJELLJES (ADABI) I UDHËTARIT, NGA NISJA DERI NË KTHIM.....	31
SHPJEGIMI PËR ÇËSHTJET QË DUHET TË DIHEN PËR LEHTËSIMET E UDHËTIMIT, SHENJAT E KIBLËS DHE KOHËT E NAMAZIT	53
NJOHJA E LEHTËSIMEVE NË UDHËTIM	55
OBLIGIMET QË LAJMËROHEN NË UDHËTIM.....	76

